# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5567
E martë, 4 shtator 2018
çmimi 0.40 €


## Hapet konkursi për pranimin e studentëve në konvikte
FAQE 6





Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


FLET PËR "EPOKËN E RE", EDITA TAHIRI FAQE 4-5

# Kuvendi t'i thotë jo ndryshimit të kufijve



**- Është koha të rikonfirmojmë se me asnjë çmim dhe në asnjë rrethanë nuk ndryshojmë kufijtë**

Ish-ministrja e Dialogut, Edita Tahiri, i ka bërë thirrje Kuvendit të Kosovës t'i thotë jo idesë për korrigjimin e kufirit me Serbinë. Ajo ka thënë se Kuvendi ka përgjegjësi historike për të dalë në mbrojtje të territorit dhe kufijve të shtetit. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Tahiri ka shprehur optimizëm se të gjitha partitë e përfaqësuara në Kuvend do ta votojnë rezolutën kundër ndryshimit të kufijve të Republikës së Kosovës. Ajo ka vlerësuar se lëvizja e kufijve në Ballkanin Perëndimor destabilizon paqen dhe stabilitetin në rajon. Tahiri ka theksuar se historikisht ndryshimi i kufijve është bërë me luftë dhe, sipas saj, ka rrezik të shkohet drejt luftës. Ajo ka deklaruar se ideja e korrigjimit të kufirit pikë qendrore ka veriun e Kosovës

QEVERIA E KOSOVËS KA EMËRUAR EKIPIN NEGOCIATOR NË KUADËR TË DIALOGUT PËR NORMALIZIMIN E MARRËDHËNIEVE NË MES TË KOSOVËS DHE SERBISË FAQE 3

# Limaj, shef i delegacionit për bisedime me Serbinë

Zëvendëskryeministri Fatmir Limaj do të jetë shef i ekipit negociator në bisedimet me Serbinë, ndërsa zëvendëskryesues i këtij ekipi do të jetë zëvendëskryeministri tjetër, Enver Hoxhaj. Anëtarë të ekipit negociator do të jenë edhe Behgjet Pacolli, Dardan Gashi, Avni Arifi dhe Mahir Jagxhillar. Kryeministri Ramush Haradinaj, i cili nuk do të jetë pjesë e këtij delegacioni, ka përsëritur edhe një herë se askush nuk ka mandat të negociojë në këtë proces për kufijtë e Kosovës






## Këtë muaj do të fillojë matja e performancës së mësimdhënësve
FAQE 6

## AKTUALE

UDHËKRYQI I MARRËVESHJES KOSOVË - SERBI DHE RIDEFINIMI I KUFIJVE SHTETËRORË TË TYRE F. 11



Arbër HADRI

QEVERIA MIRATOI PROJEKTLIGJIN PËR PAGAT F. 6

ISH-PJESËTARËT E UÇK-së KËRKOJNË SHKARKIMIN E LUMEZIT F. 7

## EKONOMI

MBI DY MILIONË EURO NDAHEN PËR KOMUNAT E VERIUT F. 9

RUKIQI DHE AZESTI ZOTOHEN PËR THELLIMIN E BASHKËPUNIMIT EKONOMIK F. 9

## KULTURË

RECENSION I LIBRIT TË AUTORIT MRSCI. HAMËZ LADROVCI, ME TITULL:"ÇËSHTJA SHQIPTARE PËRBALLË DIPLOMACISË DHE GJEOPOLITIKËS RUSOMADHE (1856-2018)"

LIBËR ME RËNDËSI TË VEÇANTË SHKENCORE DHE HISTORIKE F.12

Prof. Dr. iur. Eqrem ZENELAJ



## SPORT

CHALLANDESI: LUAJMË PËR FITORE NDAJ AZERBAJXHANIT DHE ISHUJVE FAROE F.16


RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

## Bushati takon kryeministrin izraelit Netanyahu

TIRANË, 3 SHTATOR - Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme të Shqipërisë, Ditmir Bushati zhvilloi një takim me kryeministrin, njëherësh ministrin e Jashtëm të Izraelit Benjamin Netanyahu.
Gjatë këtij takimi bashkëbiseduesit u ndalen në çështje të rëndësishme të bashkëpunimit dypalësh, zhvillimet në fushën e sigurisë në Lindjen e Mesme dhe në rajonin e Ballkanit, lufta kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, zhvillimi ekonomik dhe mbrojtja kibernetike.
Ministri e njohu kryeministrin Netanyahu me zhvillimet në rajon dhe me rolin e Shqipërisë si faktor stabiliteti. Ndërsa Netanyahu vlerësoi qasjen e Shqipërisë ndaj sfidave të sigurisë në rajon dhe më tej, si dhe shprehu interesin e Izraelit për ta forcuar më tej bashkëpunimin në këtë fushë. Bushati dhe Netanyahu diskutuan për mundësinë e bashkëpunimit në fusha me interes reciprok si inovacioni, ekonomia, arsimi, kultura etj.



# Junckeri mbështet arritjen e një marrëveshjeje Kosovë - Serbi

Presidenti i Komisionit Evropian, Jean-Claude Juncker, në bisedë telefonike me presidentin Hashim Thaçi, ka thënë se mbështet arritjen e një marrëveshjeje ndërmjet Kosovës dhe Serbisë si kusht për sigurimin e paqes afatgjatë në Ballkanin Perëndimor dhe për hapjen e perspektivës për anëtarësim në BE



PRISHTINË, 3 SHTATOR - Presidenti i Komisionit Evropian, Jean-Claude Juncker, shprehu mbështetje të plotë për arritjen e një marrëveshjeje ndërmjet Kosovës dhe Serbisë si kusht për sigurimin e paqes afatgjatë në Ballkanin Perëndimor dhe për hapjen e perspektivës për anëtarësim në BE. Këto komente Junckeru i bëri në një bisedë telefonike me presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi, thuhet në një komunikatë për media të Presidencës. Sipas së njëjtës, Thaçi dhe Junckeri kanë biseduar për procesin e liberalizimit të vizave, perspektivën evropiane të Kosovës dhe për fazën e fundit të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Thaçi tha se lëvizja e lirë për qytetarët e Kosovës duhet të vijë shpejt dhe t'i jepet fund izolimit të Kosovës.
Ndërkaq ministri gjerman për Evropën, Michael Roth, tha se ndryshimi i kufirit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë nuk do të zgjidhë asnjë problem, ndërsa mund të nxisë tensione etnike. Në një postim në rrjetin "Twitter" ai u bëri jehonë qëndrimeve kundërshtuese të Gjermanisë ndaj ideve për korrigjimin e kufirit si rrugë për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. "Të dashur miq në Kosovë dhe Serbi, rishkrimi i kufijve nuk do të zgjidhë asnjë problem. Një veprim i tillë do ta hapte 'Kutinë e Pandorës' të armiqësive etnike. E ardhmja e Ballkanit Perëndimor është thjesht shumetnike, shumëfetare dhe shumkulturore. E bashkuar në diversitet, kjo është Evropa", shkroi ministri Roth.
Të premten ministri i Jashtëm gjerman Heiko Maas tha se diskutimet për shkëmbim territoresh janë të gabuara, ndërsa më herët kancelarja gjermane Angela Merkel kishte tërhequr vërejtjen për pasojat që mund të kishte për rajonin një ndryshim kufijsh.
Shefja e politikës së jashtme të Bashkimit Evropian, Federica Nogherini tha të hënën se ekziston mundësia që Kosova dhe Serbia të arrijnë një marrëveshje për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet tyre deri në vitin e ardhshëm, kur mbahen edhe zgjedhjet në Bashkimin Evropian.
Mogherini tha se "mendoj që ekziston shansi që presidentët Aleksandër Vuçiç dhe Hashim Thaçi, të arrijnë marrëveshje gjithëpërfshirëse, detyruese e ligjore për normalizimin e marrëdhënieve që do të jetë në tërësi në pajtim me të drejtën ndërkombëtare dhe që do të ndihmonte stabilizimin e gjithë rajonit", tha ajo duke theksuar se vitin e ardhshëm "bëhen 20 vjet që nga lufta në Kosovë dhe është koha që t'i jepet fund atij konflikti".
Të dyja vendet janë përfshirë në diskutime të brendshme rreth ideve të presidentëve të tyre që kanë kërkuar mbështetje për arritjen e një marrëveshjeje që mund të përfshijë edhe korrigjimin e kufirit.
Qëndrimet janë të ndara edhe në komunitetin ndërkombëtarë midis atyre që do të pranonin një marrëveshje të tillë dhe atyre që druajnë se prekja e kufijve, mund të ripërtërijë armiqësitë në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

## Kuvendi i Shqipërisë nis punën pa opozitën

TIRANË, 3 SHTATOR - Kuvendi i Shqipërisë ka nisur punën pasditen e së hënës. Në seancën e parë mungoi opozita, që ndodhej në Shkodër për një mbledhje të jashtëzakonshme.
Në fjalën hapëse, kreu i Kuvendit, Gramoz Ruçi deklaroi se partitë politike duhet të luftojnë për qëllimin e përbashkët: integrimin e Shqipërinë në Bashkimin Evropian.
"I ftoj të gjithë që të ndajnë luftën e pushtetit nga lufta e përbashkët për integrimin në Evropë. Integrimi do të jetë objektiv i pandryshuar i Kuvendit", theksoi Ruçi.
Në kohën kur në Tiranë nisi punimet Kuvendi, opozita zhvilloi një mbledhje të jashtëzakonshme në Shkodër, aty ku sipas kreut të Partisë Demokratike, Lulzim Basha, kriminelët kanë 6 muaj që po e terrorizojnë këtë qytet. "Në më pak se 3 muaj kanë ndodhur 6 vrasje mafioze dhe janë rrëmbyer 2 persona. Kjo është situata në Shkodër. Këtu duhet të ishte kryeministri, jo për të shitur mend dhe për të bërë batuta, por për të raportuar arrestimin e kriminelëve që kanë 6 muaj që terrorizojnë Shkodrën. Por Rama nuk mund të jetë këtu, është në Tiranë me Çyrbjen, Taulant Ballën e Fatmir Xhafën", tha Basha. "Na bëjnë thirrje për bashkëpunim, por me kë të bashkëpunojmë? Me vëllanë e Xhafës? Apo me Taulant



Ballën, që i plasi skandali i Toyota Yaris-it? Ai pohoi vetë që është mik me një nga anëtarët e bandës së Lushnjes, të dënuar për trafik droge", deklaroi Basha.

EPOKA E RE
Botohet nga “Epoka e re” • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Qeveria e Kosovës ka emëruar ekipin negociator në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë

# Limaj, shef i delegacionit për bisedime me Serbinë



**Zëvendëskryeministri Fatmir Limaj do të jetë shef i ekipit negociator në bisedimet me Serbinë, ndërsa zëvendëskryesues i këtij ekipi do të jetë zëvendëskryeministri tjetër, Enver Hoxhaj. Anëtarë të ekipit negociator do të jenë edhe Behgjet Pacolli, Dardan Gashi, Avni Arifi dhe Mahir Jagxhillari. Kryeministri Ramush Haradinaj, i cili nuk do të jetë pjesë e këtij delegacioni, ka përsëritur edhe një herë se askush nuk ka mandat të negociojë në këtë proces për kufijtë e Kosovës**

EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 3 SHTATOR - Një ditë para se Kuvendi i Kosovës në një seancë të jashtëzakonshme të diskutojë për dialogut me Serbinë, Qeveria e Kosovës ka propozuar emrat e ekipit negociator për fazën finale të dialogut Kosovë - Serbi. Në mbledhjen e së hënës, Qeveria ka vendosur që kryesues i këtij delegacioni të jetë zëvendëskryeministri Fatmir Limaj, zëvendëskryesues zëvendëskryeministri tjetër Enver Hoxhaj, derisa kryeministri Haradinaj nuk është përfshirë fare në këtë delegacion. Anëtarë të këtij delegacioni janë propozuar ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, ministri i Administratës Publike, Mahir Jagxhillar, ministri i Diasporës, Dardan Gashi, si kryesuesi i deritanishëm i dialogut Avni Arifi.
Kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se emrat e delegacionit fillimisht i propozohen Kuvendit të Kosovës për miratim. Ai ka deklaruar se në këtë mënyrë Qeveria po e merr përgjegjësinë që i takon në këtë proces. "Disa herë jam akuzuar se pse nuk po marrë përgjegjësinë për dialog. Tani në rastin konkret, është Qeveria përmes zëvendëskryeministrave. Kjo është logjika e punës. Ne si Qeveri mund ta presim produktin e punës së Kuvendit, por ata nuk po e japin. Ne po e kryejmë përgjegjësinë tonë, kurse tani radhën e ka Kuvendi", thënë Haradinaj. Ai ka deklaruar se pjesë e këtij delegacioni mund të bëhen edhe subjektet politike opozitare me nga një anëtar dhe shoqëria civile.

## Haradinaj: Askush nuk ka mandat të negociojë për kufijtë

Kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj, ka deklaruar se as ky delegacion dhe askush tjetër nuk është mandatar të diskutojë me Serbinë për kufij. "Askush nuk do të ketë mandat për të luajtur me kufijtë dhe në dëm të shtetit të Kosovës", ka thënë Haradinaj në një konferencë për medie pas mbledhjes së Qeverisë. Ai ka thënë se të gjithë e kanë obligim ta mbrojnë Kushtetutën e Kosovës. "Ne kemi të gjithë obligime për ta respektuar Kushtetutën e vendit. Kushtetuta na obligon për ta mbrojtur territorin dhe kufijtë. Askush nuk e ka të drejtën ose mandatin që të negociojë për territorin ose kufijtë. Pra, si Kosovë të gjithë duhet të jemi të qëndrueshëm që të mos lejojmë askënd të diskutojë për territorin dhe kufijtë", është shprehur Haradinaj.
Shefi i ekzekutivit ka deklaruar se është shumë me rëndësi që në këtë proces të ketë më shumë mendje dhe sy që e analizojnë materien. "Disa herë u kam thënë në parlament kolegëve të LDK-së, të LV-së, të PSD-së dhe të Alternativës, më mirë është të jeni në tavolinë e jo pastaj t'i lexojnë gjërat nëpër gazeta dhe të mos dimë nëse është e vërtetë apo nuk është e vërtetë. Meqenëse ka të bëjë me Kosovën, më mirë është të jemi të pranishëm në tavolinë. Kjo është një siguri që në proces nuk do të kemi befasi të gabuar", është shprehur ai.
Haradinaj e ka ftuar Kuvendin ta bëjë punën që i takon në procesin e dialogut. "Vendimi është dypjesësh, ne si Qeveri marrim vendim për pjesën tonë të ekzekutivit. Zakonisht vendimet tona i aprovon Kuvendi. Ne kemi dhënë një pjesë të kontributit dhe mendojmë se është në interes që edhe Kuvendi ta bëjë pjesën e vet, pra t'i bëjë propozimet e tjera", ka thënë Haradinaj, duke shtuar se Kuvendi e ka mundësinë të propozojë edhe emra të tjerë.
Më 7 shtator në Bruksel do të takohen presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi dhe i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve.

## Pacolli: Labinot Tahiri mbetet pjesë e AKR-së



PRISHTINË, 3 SHTATOR (ER) - Presidenti i Aleancës Kosova e Re (AKR), Behgjet Pacolli, ka mohuar zërat për largimin e deputetit Labinot Tahiri nga kjo parti. Pacolli ka thënë se Labinot Tahiri ka qenë dhe do të jetë pjesë e AKR-së. "Labinot Tahiri ka qenë, është dhe do të jetë në AKR, pavarësisht prej thashethemeve dhe konspiracioneve. Karvani ecën përpara", ka shkruar Pacolli në llogarinë e vet në "Facebook".

Flet për "Epokën e re", Edita Tahiri

# Kuvendi t'i thotë jo n



## - Tani është koha të rikonfirmojmë se me asnjë çmim dhe në asnjë rrethanë nuk ndryshojmë kufijtë

Ish-ministrja e Dialogut, Edita Tahiri, i ka bërë thirrje Kuvendit të Kosovës t'i thotë jo idesë për korrigjimin e kufirit me Serbinë. Ajo ka thënë se Kuvendi ka përgjegjësi historike për të dalë në mbrojtje të territorit dhe kufijve të shtetit. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Tahiri ka shprehur optimizëm se të gjitha partitë e përfaqësuara në Kuvend do ta votojnë rezolutën kundër ndryshimit të kufijve të Republikës së Kosovës. Ajo ka vlerësuar se lëvizja e kufijve në Ballkanin Perëndimor destabilizon paqen dhe stabilitetin në rajon. Tahiri ka theksuar se historikisht ndryshimi i kufijve është bërë me luftë dhe, sipas saj, ka rrezik të shkohet drejt luftës. Ajo ka deklaruar se ideja e korrigjimit të kufirit pikë qendrore ka veriun e Kosovës

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 3 SHTATOR -

**"Epoka e re":** *Znj. Tahiri, sot (e martë) do të mbahet seanca e jashtëzakonshme e iniciuar nga opozita që ka për qëllim miratimin e rezolutës për mbrojtjen e integritetit territorial të Kosovës. Çfarë epilogu prisni nga ky debat parlamentar?*

**Tahiri:** Kuvendi i Kosovës ka përgjegjësi historike për t'i thënë jo ndryshimit të kufijve të shtetit të Kosovës për shumë arsye. Kosova është bërë shtet i pavarur dhe sovran falë luftës sonë për liri dhe gjakut të derdhur të heronjve, dëshmorëve dhe martirëve për këtë shtet e për këta kufij. Toka e Kosovës është e shenjtë jo vetëm për popullin e Kosovës, por edhe për kombin shqiptar, pra ruajtja e integritetit territorial të Kosovës është interes kombëtar. Shqiptarët historikisht kanë qenë humbës të tokave të tyre, tokat shqiptare janë tkurrur në vazhdimësi dhe nuk mund të lejojmë që të ndodhë kjo edhe më tutje. Ashtu siç po kundërshtohet fuqishëm nga të gjithë, edhe Kuvendi duhet ta kundërshtojë këtë ide me miratimin e rezolutës ku vihet vija e kuqe se kufijtë e Kosovës janë të pacenueshëm ashtu siç e thotë edhe Kushtetuta. Veriu i Kosovës dhe Lugina e Preshevës janë toka shqiptare dhe ato nuk mund të këmbehen. Lëvizja e kufijve në Ballkan destabilizon paqen dhe stabilitetin në rajon. Historikisht Ballkani nuk ka ndryshuar kufij me paqe, por gjithmonë janë bërë me luftë dhe ka rrezik që të shkohet drejt luftës.

**"Epoka e re":** *Por partia më e madhe në pushtet mbajtjen e kësaj seance po e quan absurde. Si e komentoni këtë kundërshtim të PDK-së?*

**Tahiri:** Pres që të gjitha partitë e përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës, pra edhe partitë në pushtet edhe ato në opozitë, ta votojnë rezolutën kundër ndryshimit të kufijve të Kosovës. Kjo fare nuk është një ngjarje absurde, por është një ngjarje e rëndësishme ku organi më i lartë i vendit, Kuvendi i Kosovës, deklarohet dhe i thotë jo ndryshimit të kufijve. Me retorikat që këto ditë janë bërë për këtë temë, në botë ka shkuar sinjali mjaft i dyshimtë për faktin se presidenti i Kosovës ka dalë me propozimin për korrigjimin e kufirit. Mirëpo u kundërshtua plotësisht nga spektri politik, nga institucionet e Kosovës, nga kryetari i Kuvendit dhe Kuvendi duhet ta konfirmojë këtë kundërshtim në mënyrë që edhe

# dryshimit të kufijve



bota ta marrë sinjalin që Kosova zyrtarisht është kundër ndryshimit të kufijve. Pra, ka shumë peshë të madhe, sidomos për disa qarqe që kanë filluar të oscilojnë në këtë çështje, ndërsa për qarqet apo faktorët ndërkombëtarë vendimmarrës që kanë folur kundër ndryshimit të kufijve kjo është edhe një përgjigje që Kosova vazhdon ta mbrojë qëndrimin se nuk ka ndryshim të kufijve.

**"Epoka e re":** *Ka rrezik të dështojë miratimi i kësaj rezolute?*
**Tahiri:** Është një përgjegjësi historike e Kuvendit dhe jam e bindur se të gjitha partitë politike parlamentare do të jenë në nivelin e përgjegjësisë shtetërore dhe përgjegjësisë strategjike në mbrojtje të territorit dhe kufijve. Jam e bindur se Kuvendi edhe një herë do ta rikonfirmojë përgjegjësinë e vet historike në mbrojtje të kufijve të Kosovës. Nuk pres që mund të ketë deputetë në Kuvendin e Kosovës i cili ka dhënë betimin për ta mbrojtur Kushtetutën e Kosovës e që mund të flasë ndryshe. Tekefundit, çdoherë që bëhemi deputet e nënshkruajmë Deklaratën e Betimit për të mbrojtur Kushtetutën e Republikës, pra për ta mbrojtur sovranitetin, integritetin territorial dhe kufijtë e Republikës së Kosovës. Mos të harrojmë se ne në Kuvend e kemi nënshkruar Deklaratën e Pavarësisë në vitin 2008 dhe kemi përgjegjësi t'i mbrojmë të arriturat shtetërore dhe përpjekjet 100-vjeçare. Tani është koha të rikonfirmojmë se me asnjë çmim dhe në asnjë rrethanë nuk ndryshojmë kufijtë.

**"Epoka e re":** *Pse po e kundërshtoni idenë e presidentit Hashim Thaçi për korrigjim të kufirit? Çfarë nënkupton me këtë ide?*
**Tahiri:** Nuk besoj se kjo është ide e presidentit Thaçi, sepse edhe z. Thaçi ka kapur pushkën për të bërë Kosovën shtet dhe për t'i mbrojtur kufijtë. Këto janë ide të Serbisë dhe të agjendave ruse të cilat provojnë që edhe më tutje në dëm të tokave të Kosovës, Serbia të krijojë favore. Ndryshimi i kufijve, këmbimi i territoreve apo korrigjimi i kufirit pikë qendrore ka veriun. Serbia kërkon ta marrë veriun sepse është i pasur strategjikisht, pra është i pasur me miniera. 'Trepça' është sot miniera më e pasur në Evropë për plumb, zink dhe për metale të rralla. Pastaj është Ujmani, pastaj është pika strategjike luftarake e vëzhgimit në malin e Kopaonikut që është në pjesën e Kosovës. Veriu është pjesa më vitale e shtetit të Kosovës. Serbia vazhdimisht ka pasur synim veriun e Kosovës, prandaj na ka mbajtur 100 vjet të kolonizuar veç pse ka qenë veriu i pasur. Kosova nuk është në pozitë që të japë toka.

**"Epoka e re":** *Por presidenti Thaçi po thotë se me korrigjimin e kufirit nuk do të ketë as autonomi dhe as ndarje të veriut, por vetëm bashkim të Luginës së Preshevës me Kosovën. Po manipulohet opinioni me këtë ide?*
**Tahiri:** Ajo çka flet z. Thaçi është veç deklaratë e tij. Unë po flas si njohëse e zhvillimeve historike politike në të gjitha fazat prej okupimit të Kosovës, por edhe pas luftës gjithmonë synimi i Serbisë ka qenë veriu, prandaj edhe tash është veriu i Kosovës. Nuk kemi të bëjmë me korrigjim, por kemi të bëjmë me një lojë të madhe të rrezikshme në dëm të interesave të shqiptarëve, sepse veriu, për fat të keq, në mendje koloniale hegjemoniste të Serbisë ende është i pranishëm. Ka qenë një pionier i Milloshevqit, si duket prej asaj kohe, ka marrë mision për ta çuar përpara idenë e Milloshevqit që është shkatërrimtare për Kosovën, pra prekjen e kufijve të Kosovës dhe veriun.

**"Epoka e re":** *Kjo ide nuk është kundërshtuar nga ShBA-ja nëse u referohemi deklaratave të këshilltarit për siguri kombëtare.*
**Tahiri:** Ka pasur një deklaratë të këshilltarit për siguri kombëtare të ShBA-së, z. Bolton, kur ka thënë se 'ShBA-ja mbështet çfarëdo marrëveshje për të cilin palët pajtohen' dhe ka thënë se 'nuk e kundërshtojnë edhe prekjen e kufirit'. Mirëpo ne duhet t'i referohemi pjesës së parë të deklaratës ku thuhet se 'nëse palët pajtohen'. E pra, ne i themi jo marrëveshjes, Kuvendi duhet t'i thotë jo ndryshimit të kufijve dhe mesazhi shkon në tavolinën e presidentit Trump, ku i thonë se Kosova është kundër ndryshimit të kufijve. Prandaj, nëse njëra palë nuk pajtohet, atëherë përgjigjja është jo. Edhe Amerika do ta respektojë sepse një palë po i thotë jo.

**"Epoka e re":** *Në rast se Kuvendi e miraton rezolutën kundër ndryshimit të kufirit, presidenti duhet të heqë dorë përfundimisht nga ideja për korrigjim të kufirit?*
**Tahiri:** Presidenti së pari nuk është dashur të dalë fare me këtë ide. Është dashur të lihet siç ka qenë gjithmonë ide e nacionalistëve të Serbisë. Krejt këto janë ide për Serbinë e madhe. Serbia është duke e synuar veriun e Kosovës dhe duke marrë parasysh se Bosnjës ia ka marrë 'Republika Serpskën', dëshiron ta bëjë Serbinë e madhe dhe përsëri të bëhet një vend që është hegjemon, pra vendi që ka më së shumti fuqi sepse natyrisht mbi tokat e të tjerëve e krijon fuqinë dhe synon të jetë mbi kombet e tjera. Por, kjo nuk lejohet. E para nuk e lejojnë shqiptarët, pastaj nuk e lejojnë kroatët. Loja është për krijimin e Serbisë së madhe dhe Rusia ka për qëllim ta rrisë ndikimin në Ballkan. Me Serbinë e sotme Rusia nuk është e kënaqur, prandaj kërkon rritjen e dimensionit të Serbisë, pra ia rrit tokat për të pasur ndikim më të madh. Ne duhet të jemi strategjikë siç kemi qenë një komb në dy shtete shqiptare dhe duhet të punojmë për interesa nacionale të shqiptarëve dhe kurrsesi për tema që shkojnë në interesa të Serbisë. Prandaj, i bëj thirrje Kuvendit që të martën t'i thotë jo idesë për ndryshim të kufijve apo për shkëmbim territoresh e korrigjim të kufijve. Kuvendi duhet t'i thotë jo ndryshimit të kufijve, ta mbrojë tokën shqiptare dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Kuvendi ka përgjegjësi historike ta bëjë këtë.

# Rashit Qalaj kërkon realizimin e objektivave strategjike të policisë

PRISHTINË, 3 SHTATOR (ER) - Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, ka mbajtur të hënën një takim zyrtar me stafin menaxherial të policisë, duke përfshirë drejtorët e departamenteve, divizioneve si dhe drejtorët rajonalë. Në këtë takim Qalaj ka kërkuar nga menaxhmenti policor realizimin e objektivave strategjike të cilat dalin nga plani zhvillimor strategjik i Policisë së Kosovës.

Drejtori Qalaj ka theksuar se nëpërmjet vlerësimit të performancës së zyrtarëve policorë, përmes menaxhimit sa më efikas të burimeve njerëzore dhe atyre logjistike, mund të arrihen rezultate edhe më pozitive në shumë sfera policore. Në këtë takim është diskutuar edhe për çështjet kyçe që kanë të bëjnë me sigurinë e qytetarit, bashkëpunimin dhe takimet me komunitetin, luftën kundër korrupsionit, sigurinë në trafik, parandalimin e veprave kriminale si vjedhjet, grabitjet, drogat etj.



## Hapet konkursi për pranimin e studentëve në konvikte

**Prishtinë, 3 shtator (ER)** - Qendra e Studentëve e Universitetit të Prishtinës (UP) ka shpallur konkursin për pranimin e studentëve për banim në konvikte dhe për ushqim në mensë, për vitin akademik 2018/2019. Konkursi do të jetë i hapur prej datës 4 shtator deri më 13 shtator. Studentët të cilët do të aplikojnë për strehim dhe ushqim në Qendrën e Studentëve, aplikimin do ta bëjnë përmes sistemit online, në adresat zyrtare të Qendrës Studentore, uebfaqes qs.rks-gov.net dhe profilit zyrtar në "Facebook" Qendra e Studentëve, Prishtinë.
Qendra e Studentëve e Universitetit të Prishtinës këtë vit do të pranojë rreth 4 000 studentë, për të cilët ofron strehim, ushqim si dhe hapësirat për lexim, studim, sport dhe aktivitete të tjera të ndryshme.
Mënyrat e përzgjedhjes së kandidatëve të cilët do ta fitojnë të drejtën për strehim dhe ushqim do të bëhet në bazë të kritereve të përcaktuara me konkurs.
Çmimi do të jetë 35 euro për muaj (20 euro banimi, 15 euro ushqimi).



# Qeveria miratoi Projektligjin për pagat



EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

**Prishtinë, 3 shtator** - Tri projektligjet tashmë të identifikuara si të rëndësishme për procesin e reformës së administratës publike kanë marrë miratimin e kabinetit qeveritar në mbledhjen e së hënës. Projektligji për pagat në sektorin publik, Projektligji për zyrtarët publikë dhe Projektligji për organizimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura janë përgatitur për një kohë të gjatë nga ekspertët dhe pritet ta rregullojnë funksionimin dhe organizimin e administratës publike në Kosovës.
Projektligji për pagat në sektorin publik përcakton sistemin e pagave dhe shpërblimeve për zyrtarët dhe funksionarët publikë që paguhen nga buxheti i shtetit dhe rregullat për përcaktimin e pagave të punonjësve të ndërmarrjeve publike në Kosovë.
Projektligji për zyrtarët publikë krijon kornizën ligjore për punësimin e zyrtarëve publikë në institucionet e Republikës së Kosovës, bazuar në meritë, integritet moral, paanësi dhe qëndrueshmëri.
Projektligji për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura përcakton rregullat e organizimit dhe funksionimit të institucioneve të administratës shtetërore dhe krijimin e një kuadri koherent ligjor për themelimin dhe performancën e institucioneve shtetërore dhe të agjencive të pavarura të themeluara nga Kuvendi i Kosovës.
Kryeministri Ramush Haradinaj e ka vlerësuar këtë si sukses të Kosovës dhe përmbushje të Agjendës së Reformave Evropiane. Kosova do të bëhet me ligj që rregullon pagesën e të gjithë nëpunësve publikë. Në këtë mbledhje të kabinetit qeveritar, Qeveria e Kosovës, në pajtim me përfundimet e Kuvendit të Republikës së Kosovës, ka dhënë mendimin për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Festat Zyrtare dhe Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të Proceduarës Penale. Për Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Festat Zyrtare mendimi i Qeverisë është se Projektligji duhet ta bëjë ndarjen e qartë të Festave Zyrtare me Festat Memoriale, ndërsa për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të Procedurës Penale thuhet se propozimet janë të panevojshme në këtë fazë.
Me vendim të miratuar nga Qeveria e Kosovës, me nga 1 000 euro janë përkrahur financiarisht 25 shoqata të familjeve të personave të zhdukur. Përkrahja u dedikohet aktiviteteve të këtyre shoqatave për shënimin e ditëve të veçanta dhe funksionimin e tyre. Ndërsa 20 400 euro janë ndarë për rehabilitimin e personave me aftësi të kufizuara.

## Haradinaj u premton zgjidhje banorëve të fshatrave të Ferizajt

**Ferizaj, 3 shtator (ER)** - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka vizituar të hënën vendin ku po mbahej protesta e organizuar nga banorët e fshatrave Bablak, Lubovc, Tërn, Koshare dhe Slivovë të Komunës së Ferizajt, me të cilët ka bashkëbiseduar për t'i dhënë zgjidhje kërkesës së tyre për ndërtimin e rrugës që i lidh fshatrat e tyre me magjistralen e Ferizajt dhe atë të Shtimes.
Haradinaj ka premtuar se Qeveria e Kosovës është e përkushtuar t'u krijojë lehtësira të gjithë banorëve të këtyre fshatrave dhe qasje në rrugët magjistrale. Duke parë nga afër gjendjen në të cilën ndodhen këto rrugë, e sidomos pas vërshimeve të fundit të cilat i kanë dëmtuar në masë të konsideruar rrugët e këtyre fshatrave, kryeministri Haradinaj ka theksuar gatishmërinë e Qeverisë që të gjendet një zgjidhje sa më e shpejtë për banorët e këtyre fshatrave. "Po punojmë që të gjendet një mënyrë sa më e shpejtë për t'i kaluar të gjitha etapat që kanë mbetur. Ne nuk ndërhyjmë në punën e institucioneve të pavarura, por besoj se të gjithë janë të vetëdijshëm që të hiqen pengesat për ta filluar ndërtimin e rrugës", është shprehur kryeministri Haradinaj. Ai i ka siguruar banorët se Qeveria do të marrë përsipër që t'i kryejë punët e mbetura për ndërtimin e rrugës që i lidh këto fshatra me rrugët magjistrale.



Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (MAShT) ka bërë të gjitha përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2018/2019

# Këtë muaj do të fillojë matja e performancës së mësimdhënësve

**Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë (MAShT), Shyqiri Bytyqi, ka thënë të hënën se janë bërë përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2018/2019. Ai ka treguar se në 11 shkolla nuk ka filluar mësimi për shkak të disa vonesave për përfundimin e punëve për renovim të objekteve. Ministri ka paralajmëruar se këtë muaj do të fillojë matja e performancës së mësimdhënësve**

EPOKA E RE Arbisa SHEFKIU

Prishtinë, 3 shtator - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë (MAShT), Shyqiri Bytyqi, ka thënë se ministria që drejton ka bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme për një fillim të mbarë të vitit shkollor 2018/2019, ndërsa ka theksuar se MAShT-i do të vazhdojë të jetë afër drejtorive komunale të arsimit dhe shkollave gjatë tërë vitit, në mënyrë që problemet eventuale të zgjidhen me kohë.

Në një konferencë për media, ministri Bytyqi ka uruar të gjithë nxënësit, mësimdhënësit dhe prindërit për fillimin e vitit të ri shkollor dhe ka kërkuar angazhim maksimal nga të gjithë, në mënyrë që nxënësve t'u ofrohen dije dhe shkathtësi të nevojshme për të ardhmen e tyre dhe të vendit.

Duke folur për përgatitjet që ka bërë MAShT-i për fillimin e vitit të ri shkollor, ministri Bytyqi ka përmendur punën që është bërë për përmirësimin e infrastrukturës nëpër shkollat tona dhe për ndërtimin e disa shkollave të reja.

Ministri ka thënë se është punuar edhe për infrastrukturën ligjore, ku veçoi hyrjen në fuqi të Ligjit për Inspektoratin e Arsimit, për të cilin ka theksuar se do të hapë rrugë për një prani më të madhe të inspektoratit të arsimit në sistemin arsimor. "Kjo është një mundësi e mirë, sepse tashmë kemi paralajmëruar se në shtator do të fillojë edhe matja e performancës së mësimdhënësve dhe ligji i ri do të na krijojnë lehtësira për fillimin e këtij procesi", ka thënë Bytyqi.

Ministri Bytyqi ka theksuar se është duke u punuar edhe në Ligjin për tekste dhe mjete mësimore, që do të ndihmojë që të kemi tekste të reja dhe në përputhje me standardet e nevojshme. Ndërsa ministri ka përmendur edhe faktin se pas përpjekjeve që ka bërë MAShT-i, gjatë këtij viti do të ketë shtesë në sistemin arsimor edhe 100 asistentë për fëmijët me nevoja të veçanta.

Ministri Bytyqi ka pohuar se është duke vazhduar puna me programet lëndore për të gjitha klasat, ndërsa është bërë thirrja publike për tekstet e reja shkollore për nivelin 0, 6, 8 dhe 10 dhe për pjesën e dytë do të bëhet shpallja këtë muaj për klasat 2, 7 dhe 11. Po ashtu, ai ka theksuar se nuk është lanë anash edhe arsimi për komunitetet, duke përmendur se janë përgatitur programet lëndore për gjuhën boshnjake.

Ministri ka vlerësuar se sivjet është bërë një përgatitje e kënaqshme, pavarësisht se ka pasur disa pengesa për fillimin e vitit të ri shkollor në disa shkolla. "Janë 11 shkolla në tërë Kosovën, sipas informatave që kemi, ku sot nuk do të fillojë mësimi për shkak të disa vonesave në përfundimin e punëve për renovimin e shkollave", është shprehur ministri Bytyqi. Ai ka treguar se është bërë shpërndarja falas e teksteve shkollore nga klasa 1 deri 9 dhe deri më tani janë shpërndarë tekstet në 15 komuna, ndërsa pritet që deri më 6 shtator të përfundojë shpërndarja në të gjitha komunat.

Ministri Bytyqi ka folur edhe për testin e maturës, për të cilin ka pohuar se është arritur synimi për të pasur një rezultat real, ndërsa ka paralajmëruar hapjen e debatit publik për qasjen ndaj testit të maturës dhe mënyrës se si do të trajtohet më tutje ky proces i vlerësimit të nxënësve.




## Ish-pjesëtarët e UÇK-së kërkojnë shkarkimin e Lumezit

Prishtinë, 3 shtator - Ish-pjesëtarë të UÇK-së të Brigadës 113 "Mujë Krasniqi", e cila ka vepruar në kuadër të Zonës Operative të Drenicës, kanë protestuar të hënën në Sheshin "Skënderbeu" në Prishtinë, me kërkesën për largimin e veteranëve të rremë nga lista e përfituesve të pensioneve.

Organizatori i kësaj proteste, Faik Zogaj, pati tri kërkesa për Kuvendin e Kosovës. "Kërkesat tona janë tri: Kërkojmë që sa më shpejt të pastrohet lista e veteranëve, jo të ketë manipulues dhe të bëhet një ligj për veteranët që t'i ketë parimet e veta. Çdo veteran t'i gëzojë të drejtat e veta. Një veteran i vërtetë i merr 170 euro dhe të njëjtat i merr edhe një falsifikator", ka thënë Zogaj.

Protestuesit kanë kërkuar edhe shkarkimin e kryeprokurorit të shtetit, Aleksandër Lumezi. "Sot erdhëm vetëm për njoftim. Nëse 24 manipuluesve nuk u ndalet rroga, atëherë do të bëjmë që t'u ndalet edhe veteranëve të vërtetë. Nëse kryetari nuk na bën zgjidhje brenda 30 ditësh, ne nuk do të ndalemi. Kemi luftuar për këtë vend. Tekefundit, le t'u ndalet pensioni të gjithë veteranëve deri në spastrimin e listave", ka thënë ai.



# Kërkohet nga drejtorët e Komunës së Mitrovicës t'i përgatisin planet e punës

MITROVICË, 3 SHTATOR (ER) - Bordi i Drejtorëve në Komunën e Mitrovicës ka mbajtur të hënën mbledhjen e radhës, e cila është kryesuar nga nënkryetari i komunës, Faruk Mujka.
Shefi për Buxhet dhe Financa në Drejtorinë për Financa, Zenel Çitaku, ka prezantuar tabelat finale për buxhetin e vitit 2019 të cilat janë proceduar në Komitetin për Politikë dhe Financa. Ndërsa drejtori për Auditim të Brendshëm, Nexhat Berani, në lidhje me shqyrtimin e planit të veprimit për implementimin e rekomandimeve të dhëna nga Zyra Kombëtare e Auditimit për vitin 2017, ka theksuar se drejtorët nga muaji shtator duhet t'u kushtojnë rëndësi të hyrave vetjake dhe të merren me rekomandimet e auditorit të jashtëm dhe të brendshëm.
Kurse drejtori për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, Egzon Jashari, ka njoftuar ekzekutivin për rishpalljen e ankandit publik për Qendrën Tregtare në Mitrovicë, duke theksuar se kushtet për aplikim janë të njëjta dhe se shpreson në ofertues seriozë të cilët i plotësojnë kriteret që kërkohen.
Ndërsa drejtori për Inspeksion, Hysni Ahmeti, ka informuar të pranishmit për rrënimin e shtëpive të cilat janë afër Liqenit Akumulues, duke saktësuar se shtëpitë do të rrënohen më 7 shtator, sipas vendimit të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Po ashtu, drejtori Ahmeti ka informuar të pranishmit edhe për vizitat që u kanë bërë 20 shkollave në Komunën e Mitrovicës, duke bërë me dije se vetëm gjashtë prej tyre i plotësojnë kushtet higjiene-sanitare, ndërsa 14 shkolla kanë mungesë të mjeteve. Nënkryetari i Mitrovicës, Faruk Mujka, ka kërkuar nga drejtorët ta përgatisin planin e punës për katër muajt e ardhshëm.






# Komuna e Prishtinës, memorandum bashkëpunimi me Asociacionin e Arkitektëve

PRISHTINË, 3 SHTATOR (ER) - Komuna e Prishtinës, bashkë me Asociacionin e Arkitektëve të Kosovës, ka nënshkruar të hënën memorandum mirëkuptimi për bashkëpunim të ndërsjellë për përgatitjen e konkursit ndërkombëtar për konceptet ideore që ndërlidhen me projektin e Sallës Koncertale në qendër të Prishtinës.
Përmes këtij memorandumi Asociacioni i Arkitektëve të Kosovës ka përgjegjësi që të ofrojë ekspertizë në fushën e arkitekturës për konkursin ndërkombëtar; do të ofrojë ekspertizë teknike për realizimin e projektit; të mbledhë materiale dhe të dhëna profesionale të nevojshme për aplikuesit; t'i përpilojë termat e referencës dhe detyrën projektuese për konkursin ndërkombëtar; t'i respektojë afatet kohore të parapara për përfundim të shërbimeve; si dhe të bashkëpunojë me komunën gjatë gjithë implementimit të aktiviteteve. Ndërsa Komuna e Prishtinës do të ofrojë mbështetje institucionale me qëllim të arritjes së synimeve të kësaj marrëveshjeje, si dhe do të ofrojë mbështetje financiare për Asociacionin e Arkitektëve të Kosovës.



# Jashari viziton shkollat e Skenderajt, kërkon nga nxënësit përkushtim në mësime

SKENDERAJ, 3 SHTATOR (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari dhe drejtori për Arsim, Bekim Latifi, kanë vizituar disa shkolla të kësaj komune me rastin e fillimit të vitit të ri shkollor 2018/2019. Fillimisht ata kanë vizituar shkollën "Idriz Berani" në Klinë të Epërme, pastaj shkollat fillore në qytetin e Skenderajt "Shaban Jashari" e "Ahmet Delia", shkollat e mesme Gjimnazin "Hamëz Jashari" e "Anton Çettën", ku kanë uruar mësimdhënësit dhe nxënësit për fillimin e vitit shkollor.
Në të gjitha këto vizita kryetari Jashari ka kërkuar nga nxënësit përkushtim në mësime, duke u shprehur i lumtur që ka vërejtur vullnet tek nxënësit dhe të mësimdhënësit, për punë dhe angazhim të përbashkët në ngritje të cilësisë së arsimit. "Në mënyrë të veçantë dua t'i përshëndes e t'i uroj 800 nxënësit që për herë të parë sot ulen në banka shkollore, në mesin 10 500 nxënësve të komunës sonë. Pa dyshim ju jeni e ardhmja e ndritshme e vendit tonë. Dita e sotme është po kaq e veçantë edhe për mësimdhënësit, në misionin e tyre fisnik e të shenjtë, të cilët i falënderoj për durimin, dashurinë dhe urtësinë, me të cilat mësojnë dhe edukojnë breza të tërë nxënësish", ka thënë Bekim Jashari.

# Asfaltohen rrugët në fshatin Nikaj

KAÇANIK, 3 SHTATOR (ER) - Realizimi i projekteve kapitale në Komunën e Kaçanikut është duke u zhvilluar sipas dinamikës së planifikuar. Në kuadër të këtyre projekteve, të hënën është bërë asfaltimi i rrugës në fshatin Nikaj. Për ta parë nga afër ecurinë e punimeve, vendpunishten e ka vizituar nënkryetari i Kaçanikut, Ylber Bajra dhe drejtorin për Shërbime Publike, Ramadush Osmani.
Nënkryetari Bajra ka uruar banorët për asfaltimin e rrugës, ndërsa ka shtuar se të gjitha projektet që janë duke u realizuar kanë për qëllim mirëqenien qytetare dhe lehtësimin e qarkullimit. Projekti "Ndërtimi i rrugëve në fshatin Nikaj" ka kushtuar 25 682 euro, mjete të ndara nga buxheti komunal.



# Rukiqi dhe Azesti zotohen për thellimin e bashkëpunimit ekonomik

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 3 SHTATOR - Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Berat Rukiqi, dhe kryetari i Odës Ekonomike të Maqedonisë, Branko Azesti, janë zotuar për thellimin e bashkëpunimit ekonomik ndërmjet dy vendeve. Njëzëri ata kërkuan të bëhet më tepër për rregullimin e infrastrukturës, e cila do të lehtësojë të bërit më mirë të biznesit. Në një konferencë për media, e cila është mbajtur të hënën në fshatin Doganaj, kryetari i OEK-ut, Berat Rukiqi, ka thënë se Maqedonia është një nga partnerët tregtar kryesor të vendit tonë, me të cilën nuk ka pasur ndonjë problem të natyrës së barrierave ekonomike. Ai ka thënë se përfundimi i autostradës Prishtinë - Hani i Elezit do ta mundësojë shtimin e bashkëpunimit ekonomik me Maqedoninë.

Rukiqi ka folur edhe për çështje politike të cilat po ndikojnë në agjendën ekonomike. Ai ka thënë se referendumi për emrin e Maqedonisë dhe dialogu Kosovë - Serbi janë disa prej pengesave që ekonomia të mos jetë prioritet në rajon.

Rukiqi u ka bërë thirrje qeverive të dyja vendeve të mos bëhen pengesë për bizneset private. "E kam thënë edhe më herët dhe po e përsëris prapë, se asnjë proces politik nuk duhet ta pengojë zhvillimin ekonomik. Ne si Odë Ekonomike nuk do të ndalemi në ndihmesën që do të japim për sektorin privat", është shprehur Rukiqi.

Ndërsa kryetari i Odës Ekonomike të Maqedonisë, Branko Azesti, ka thënë se takimet e tilla do të mbahen çdo muaj pasi, sipas tij, bashkëpunimi regjional është bazament i përparimit të vendeve. Ai ka premtuar se do ta paraqesë si kërkesë pranë qeverisë maqedonase që punimet e autostradës Shkup - Prishtinë të kryhen sa më shpejt.



# Mbi dy milionë euro ndahen për komunat e veriut



PRISHTINË, 3 SHTATOR (ER) - Këtë verë Bordi Drejtues i Fondit të Zhvillimit ka ndarë më shumë se 2.1 milionë euro për projekte në veri të Kosovës. Mbi 700 000 euro i janë ndarë Zveçanit për zhvillimin e infrastrukturës komunale, përfshirë edhe mbështetjen për projektin e BE-së në zhvillim "Deponia rajonale".

Bordi i ka ndarë Leposaviqit 400 000 euro për ta ndihmuar zhvillimin e kultivimit të mjedrës në komunë dhe afër 500 000 euro për fazën e dytë të ndërtimit të pishinës në Zubin Potok.

Bordi Drejtues ka ndarë 500 000 euro për dy projekte në Mitrovicën e Veriut, përkatësisht për fazat e dyta të Sallës së Sporteve dhe ndërtimin e një objekti për Brigadën e Zjarrfikësve.

Fondi i Zhvillimit është rezultat i dialogut Prishtinë - Beograd. Fondi financohet nga tatimet e mbledhura në pikëkalimet Jarinjë/Rudnicë dhe Tabavijë/Bërnjak.

Që nga viti 2013, në Fond janë mbledhur 14.8 milionë euro, ndërsa deri tani janë ndarë më shumë se 10 milionë për ta mbështetur zhvillimin socio-ekonomik të katër komunave në veri të Kosovës.

# AKP-ja shpall fituesit e shitjeve përmes likuidimit nr. 40

PRISHTINË, 3 SHTATOR (ER) - Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) të hënën në ceremoninë e hapjes së ofertave të shitjeve nr. 40 përmes metodës së likuidimit ka shpallur çmimet më të larta të ofruara për asetet e ndërmarrjeve shoqërore që ishin në dispozicion për shitje. Për 91 asete sa ishin në shitje përmes kësaj vale të tenderuar, gjithsejtë vlera e tërësishme e ofertave më të larta ishte 2,228,962 euro. "Dorëzimi i ofertave nga investitorët, hapja e ofertave dhe publikimi i rezultateve u bënë në mënyrë transparente para përfaqësuesve të medieve, përfaqësuesve të Odës Ekonomike të Kosovës dhe Odës së Avokatëve të Kosovës si dhe investitorëve të pranishëm, ndërkaq është bërë transmetimi drejtpërdrejt i ceremonisë përmes faqes zyrtare të internetit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit", është bërë me dije në njoftimin e AKP-së.



# Udhëkryqi i marrëveshjes Kosovë - Serbi



Arbër HADRI

Marrëveshja Kosovë - Serbi dhe mundësia e ridefinimit të kufijve shtetërorë të tyre është një çështje e cila duhet të trajtohet me kujdes dhe në përputhje me interesat kombëtare të Kosovës.

Jetësimi i procesit të bisedimeve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, tanimë disavjeçar, është i padiskutueshëm për Bashkësinë Ndërkombëtare, nuk ka asnjë hapësirë për mundësinë e mospërfilljes së tij, si dhe ka arritur në pikën kritike të imponimit të Asociacionit të Komunave Serbe me veçori të theksuara ekzekutive dhe politike. Pra, nuk ka alternativë tjetër me të cilën Kosova do të mund ta anashkalonte mundësinë e bisedimeve dhe injorimin e këtij procesi që në fund detyrimisht nënkupton lëshim pe për disa çështje shumë të ndjeshme për Kosovën. Ky udhëkryq në të cilën gjendet Kosova nuk mund të anashkalohet me futjen e kokës në rërë dhe me pretendimin se çdo gjë do të tejkalohet vetvetiu.

Veprimi i politikës reale po na afrohet dhe një qasje parandaluese është më se e nevojshme për ndalimin e destabilizimit të Kosovës nga ana e veprimeve të Serbisë, nëpërmjet nxitjes së krijimit artificial të një autonomie rrënuese për rendin demokratik të Kosovës.

Serbia është në një ofensivë politike e cila me nxitjen me çdo kusht të idesë së autonomisë serbe në Kosovë po provokon seriozisht stabilitetin dhe sigurinë kombëtare të Kosovës. Arritja në një situatë të tillë është një temë në vete. Pjesë të një plani të tillë të Serbisë për faktorizimin serb në Kosovë janë edhe planet "millosheviqiane" më radikale për nxitjen e konflikteve civile dhe veprimin paramilitar në kuadër të kësaj autonomie të "Listës Serbe", si dhe përshirjes më pas të bashkësisë ndërkombëtare për parandalimin e konfliktit të brendshëm dhe miratimin e një status-quo të ri të krijuar në një Kosovë de fakto federale, me një qasje të njëjtë sikurse në Bosnjë.

Anashkalimi i kësaj situate do të mund të ishte i mundshëm nëse Kosova do të ishte tanimë një shtet i konsoliduar mirë, i cili mund t'i udhëheqë proceset politike të brendshme dhe ndërkombëtare rreth saj; administrata, policia, ligji dhe rendi kushtetues vepron në çdo cep të Kosovës dhe nuk kundërshtohet nga një popullatë tani politikisht unike; një shtet me një ushtri shumë të fortë kompatibile me rrezikshmërinë e cila e cenon dhe e cila do të ishte e aftë ta mbronte me sukses sovranitetin dhe integritetin territorial të saj në secilën rrethanë. Po ashtu, disa inkursione njëditore policore një herë në pesë vjet në veri të Kosovës nuk vërtetojnë ushtrimin e sovranitetit, përkundrazi vërteton brishtësinë institucionale dhe mosushtrimin e rendit e ligjit gjatë tërë kohës. Ky mosveprim ka prodhuar mbretërimin e një joligjësie të stilit të Perëndimit të egër, duke rezultuar me formimin e autoriteteve politike dhe monopole ekonomike antikushtetuese. Bashkësia ndërkombëtare si sponsoruese e shtetit të Kosovës do të duhej të ishte unike dhe të përkrahte një qasje të tillë të sforcimit të dhunshëm të rendit kushtetues në tërë territorin e Kosovës. Mirëpo, për më shumë Bashkësia Ndërkombëtare edhe një herë po dëshmon se është e paaftë të veprojë në mënyrë parandaluese para akteve agresore të fshehta të shteteve në Ballkan, si dhe të ketë një veprim parandalues efektiv ndaj një politike ekspansioniste të Serbisë. Një pozitë e tillë favorizuese e Kosovës është shumë larg e të qenit e realizueshme dhe mund të jetë pjesë e një strategjie afatmesme kombëtare.

Përballë një pozite të tillë të imponimit të një autonomie për minoritetin serb brenda Kosovës dhe mundësisë tani në horizont të një ridefinimi të kufijve të Kosovës dhe Serbisë me premisa të shteteve sovrane e të barabarta, si dhe të bazuar në reciprocitetin e sipërfaqes së njëjtë të kufizimit territorial dhe bashkëngjitjes Kosovës së popullatës shumicë shqiptare të robëruar në Luginën e Preshevës, është më se e qartë se interesi kombëtar është mundësia e përfitimit nga një situatë e tillë e cila tani është vënë në dispozicion. Ky proces duhet të udhëhiqet si duhet dhe duke u bazuar në parime të definuara qartë.

Guximi për të trajtuar një çështje të ndjeshme sikurse ajo e ridefinimit të kufirit dhe territoreve të Kosovës dhe Serbisë është një vendim që në vete bartë shkëputje nga stereotipat miope të krijuara nga trashëgimia jonë historike që daton që nga Kongresi i Berlinit 1878, konferencat e tjera të Londrës, Parisit, Bunjajit, Jaltës, Dejtonit, Rambujesë, Marrëveshjes së Kumanovës si dhe të status quo-s së krijuar për një dekadë në Kosovë. Kjo trashëgimi historike ka të bëjë me trajtimin brenda shoqërisë sonë të faktorëve të tkurrjes dhe copëtimit territorial të kombit shqiptar dhe të krijimit të një kompleksi kundruall saj, si në marrëdhëniet e saj me Serbinë nga e cila edhe është pavarësuar, po ashtu edhe të pozitës së Kosovës në arealin ndërkombëtar. Pyetja është se a është e gatshme shoqëria e Kosovës dhe ajo e Serbisë që problemet e tyre historike dhe të sotme që, në fakt, mpiksin çështje të kufizimeve territoriale dhe të ndasive të thella etnike e kulturore, të trajtohen e ballafaqohen paqësisht me një qasje të tillë të ridefinimit të territoreve të tyre?! Nëse ky proces do të udhëhiqej si duhej dhe me përfitim të barabartë ndërmjet palëve, atëherë ky do të ishte shumë i favorshëm për Kosovën, Serbinë dhe rajonin. Mirëpo, i njëjti është një proces shumë vështirë i realizueshëm me plot pengesa dhe me anë pozitive dhe negative.

Fakt është se negociatat për ridefinim të kufirit janë duke u zhvilluar në nivelin më të lartë dhe nevojitet një ndihmë e përgjithshme dhe kujdes i zgjeruar për mbarëvajtjen e tyre në favor të Kosovës. Mos të harrojmë se një ndër kushtet e para që na pret do të jetë delitimimi i kufirit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Një marrëveshje paqësore e definimit të kufirit vetëm sa do ta plotësonte këtë kusht të domosdoshëm drejt integrimit të Kosovës në strukturat euroatlantike.

Në kontekstin pozitiv, duhet të merren parasysh një sërë parimesh themelore gjatë procesit negociator të cilat nuk do të duhej në asnjë mënyrë të anashkalohen apo të devijohen. Këto parime me rëndësi për Kosovën dhe të ardhmen e saj janë:

1. Njohja nga ana e Serbisë e shtetit të pavarur dhe sovran të Kosovës.
2. Ridefinimi territorial të realizohet në bazë të reciprocitetit të sipërfaqes së njëjtë të kufizimit territorial ndërmjet shteteve të Kosovës dhe Serbisë, me ç'rast Kosova, sipas marrëveshjes përfundimtare, duhet të ketë të njëjtën sipërfaqe prej 10 905 km2, sikurse para fillimit të këtij procesi.
3. Përfshirja e plotë e popullatës shqiptare të Luginës së Preshevës që numëron rreth 100 000 banorë, në kuadër të sovranitetit territorial të Kosovës.
4. Përfshirja e plotë e popullatës shqiptare që jeton në pjesët veriore të Kosovës në kuadër të sovranitetit territorial të Kosovës. Në këtë kuadër duhet të përfshihen: qyteti i Mitrovicës (pjesa veriore), Boletin, Zhazhë, Kelmend, Bistricë e Shalës, Cerajë, Koshtovë, si dhe të gjitha fshatrat dhe vendbanimet e tjera të populluara nga shqiptarët.
5. Ruajtja e pikave gjeostrategjike, interesave ekonomike të Ujmanit, resurset minerare dhe Trepçën, si dhe interesat e sigurisë kombëtare për Kosovën.
6. Anëtarësimi i Kosovës me të drejta të plota në Kombet e Bashkuara dhe në organizatat e tjera ndërkombëtare.
7. Të drejtat e minoriteteve të mbesin vetëm ato të përcaktuara sipas Kushtetutës së tanishme të Kosovës, minus e drejta e votës së dyfishtë.
8. Krijimi i Ushtrisë së Kosovës dhe njohja e përkrahja rajonale dhe ndërkombëtare e saj. Marrëveshje e veçantë me NATO-n për sigurinë e përbashkët në Kosovë, në periudhën kalimtare deri me anëtarësimin e Kosovës në këtë organizatë.
9. Kërkimfalja e Serbisë për gjenocidin, aparteidin, masakrat dhe spastrimin etnik ndaj shqiptarëve të Kosovës nga ana e regjimit millosheviqian të Serbisë.
10. Kompensimi material nga ana e Serbisë i dëmeve të shkaktuara në luftën në Kosovë gjatë viteve 1998-1999.
11. Mosndërhyrja e Serbisë në punët e brendshme të Kosovës, duke përfshirë çështjet administrative e të sigurisë në nivel të Kosovës dhe komunal; të drejtat pronësore e operative të ndërmarrjeve shoqërore dhe shtetërore të Kosovës; kthimi i koleksioneve muzeore dhe arkivore të Kosovës.
12. Trashëgimia fetare ortodokse është trajtuar sipas standardeve më të larta botërore duke u bazuar në Pakon e Ahtisarit dhe Kushtetutën e Kosovës.
13. Projekte infrastrukturore ndër-rajonale, me përkrahje të Bashkimit Evropian.
14. Deklaratë politike e Komisionit dhe Parlamentit Evropian për përkrahjen e përshpejtuar të anëtarësimit të Kosovës dhe Serbisë në Bashkimin Evropian dhe mospengimin e njëra-tjetrës në këtë proces.

Nëse këto parime do të realizohen në plotësi pa ndryshime esenciale që do ta bënin të papranueshme marrëveshjen potenciale, atëherë Kosova nuk ka pse të frikësohet nga përfshirja e një pjese të popullatës së saj, që do të ishte pozitive për qenien e saj kombëtare dhe zhvillimin e mëtejmë të saj.

Në këtë situatë është me rëndësi që interesat kombëtare të Kosovës të vendosen të parat, para pikëpamjeve të ndryshme të partive politike, automatizmit në kundërshtim dhe politikës ditore. Mekanizmat filtrues të sovranit për kontrollimin dhe miratimin e rezultateve të bisedimeve - marrëveshjes janë në vend, me ushtrimin e së drejtës sublime të referendumit popullor, por edhe të drejtave të tjera kushtetuese. Duke e shikuar nga ky prizëm apartiak, formati i udhëheqjes së bisedimeve nga ana e presidentit të Kosovës, Thaçit, i cili e ka një përvojë dhe qëndrueshmëri të dëshmuar negociuese nga Konferenca e Rambujesë, është i favorshëm në këtë konstelacion kur presioni do të jetë evident që rezultati i bisedimeve të jetë i përshtatshëm për opinionin e brendshëm kosovar, si dhe që projektmarrëveshja duhet të miratohet nga Kuvendi apo nga referendumi gjithë popullor.

Në aspektin historik territori i Kosovës së sotme është përcaktuar në vitin 1945 me krijimin e Jugosllavisë Federale, me disa ndryshime me rritjen e sipërfaqes së saj me bashkëngjitjen e disa territoreve të Komunës së Leposaviçit dhe Zveçanit në vitet e '50-ta dhe shkëputjes së disa fshatrave të Komunës së Gjilanit. Me ndryshime të vogla të definimeve ndërkomunale brenda Kosovës, territori i saj ka mbetur i pandryshuar që nga ajo kohë dhe vetëm është vërtetuar me Kushtetutat e viteve 1946, 1948, 1968, 1974 dhe më pas me Marrëveshjen e Kumanovës dhe Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës, si dhe Kushtetutën e Kosovës së Pavarur. Territori i saj është reflektim i një sipërfaqe kompakte të bashkëdyzuar gjeografike, etnografike, kulturore e politike të Rrafshit të Kosovës dhe të Rrafshit të Dukagjinit, faktor i cili ka qenë edhe përcaktues për definimin e territorit të saj në Konferencën e AVNOJ-it dhe më pas me krijimin e Jugosllavisë së re në vitin 1945. Fatkeqësisht, Lugina e Preshevës me karakteristika të veçanta gjeografike nuk i është bashkangjitur territorit politiko-administrativ të Kosovës, por ka mbetur nën Serbi, pavarësisht prej faktit se ka të njëjtat karakteristika të përbërjes etnike shqiptare, kulturës dhe historisë së përbashkët. Të njëjtin fat e kanë pësuar edhe shqiptarët në Maqedonisë e sotme, e cila si etnitet i ri politik - republikë - është krijuar po atë vit më 1945, me ç'rast territori i banuar me shqiptar është shkëputur në aspektin politik dhe administrativ nga përkatësia në Kosovën natyrale. Kompaktësia territoriale e këtyre tri pjesëve të një trungu etnik dhe kulturor në aspektin historik kanë qenë të jetësuara me Vilajetin e Kosovës në shekullin XIX, në të cilin kanë qenë të përfshira të gjitha këto territore të banuara me shumicë shqiptare, si dhe pjesërisht gjatë Luftës së Dytë Botërore, por pa pjesët e skajshme veriore të saj. Gjatë periudhës së Mbretërisë Jugosllave pas Luftës së Parë Botërore, shqiptarët që kanë jetuar në këtë shtet kanë qenë të ndarë në rajone të ndryshme administrative pa të drejta elementare njerëzore.

Duke u bazuar në të dhënat historike, mund të konkludojmë se territori i etnitetit politiko-juridik të Kosovës së sotme është i cunguar dhe nuk pasqyron territorin e Kosovës historike dhe natyrale, të kompaktësisë etnike dhe kulturore në të cilën hyn edhe pop-

# dhe ridefinimi i kufijve shtetërorë të tyre

ulli shqiptar i ndarë në Luginën e Preshevës dhe në Maqedoni gjatë ish-Jugosllavisë. Kufijtë e Kosovës së sotme janë definuar pas Luftës së Dytë Botërore me krijimin e rendit të ri botëror dhe nga interesat e krijimit të Jugosllavisë Federale, si dhe nuk janë rezultat i imponimit dhe caktimit të dhunshëm me luftë.
Gjatë gjithë periudhës pasuese deri me pavarësinë politike të saj, Kosova e ka mirëmbajtur, mbrojtur me sakrificë dhe vërtetuar të njëjtin territor gjatë ndryshimeve të pozitës së saj politiko-juridike.
Efektet e mundshme negative të një marrëveshjeje të definimit paqësor të kufijve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë mund të ndikojnë vetëm në ato vende të Ballkanit që nuk i kanë të rregulluara si duhet marrëdhëniet ndëretnike në sistemin e tyre shtetëror dhe në të cilat ekzistojnë nëpërkëmbje dhe shtypje të të drejtave njerëzore. Në këtë rreth hyn Maqedonia, e cila duhet t'i rikompozojë me Kushtetutë marrëdhëniet e barabarta të dy popujve shtetformues, shqiptarëve dhe sllavëve maqedonas, para se të hyjë në NATO dhe në Bashkimin Evropian, në mënyrë që problemet evidente të brendshme dhe mundësia e konfliktit të mos bartet në nivelin evropian.
Bosnja është një tregim në vete në të cilën Bashkësia Ndërkombëtare ka investuar konsiderueshëm në krijimin e formulës së paqes e stabilitetit dhe nuk do të lejojë që të këtë ndryshime të cilat do ta ndikonin në shpërbërjen e saj dhe përfshirjen në një konflikt më të gjerë të shteteve që e rrethojnë e që janë edhe pjesë e NATO-s dhe Bashkimit Evropian.
Mirëpo, Kosova është në miqësi të mirë me shtetet që e rrethojnë, nuk ka aspirata territoriale ndaj tyre dhe duhet t'i zgjidhë problemet e saj të brendshme. Reflektimi i tyre në marrëdhëniet ndërkombëtare rregullohet natyrshëm nga interesat e fuqive të mëdha dhe rendi botëror.
Element negativ në hapjen e bisedimeve për definimin e kufijve është mundësia e mosarritjes së një marrëveshjeje ndërmjet palëve, e që do t'i mbante hapur dhe ashpërsonte mosmarrëveshjet historike ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, si dhe do ta rriste nivelin e rrezikshmërisë së nxitjes së konfliktit të brendshëm të përkrahur nga Serbia. Po ashtu, një tjetër faktor negativ që është historikisht i dëshmuar është tendenca për manipulimin e procesit nga ana e Serbisë, mosrespektimi i marrëveshjeve dhe devijimi nga qëndrueshmëria afatgjatë e paqes dhe prosperitetit të ndërsjellët. Kjo tendencë për manipulim të procesit, që është gjithmonë në lojën politike të shahut që e ushtron Vuçiqi, duhet të vrojtohet me kujdes dhe të anashkalohet me çdo kusht me ndihmën e bashkësisë ndërkombëtare. Prezantimi i një ujdie nga ana e tij në të cilën të gjitha palët do të përfitojnë, nga përvojat e shumta ballkanike, duket shumë e mirë që të jetë e vërtetë.

Marrëveshja Kosovë - Serbi dhe qëndrimi i administratës së re amerikane

Pozita momentale e Kosovës është e pafavorshme si në aspektin e funksionimit të brendshëm demokratik dhe të sigurisë, po ashtu edhe në dimensionin e pozitës së saj ndërkombëtare. Është më se e qartë se Serbia gjatë dy vjetëve të fundit në krye me Vuçiqin, duke e përdorur brishtësinë e stabilitetit dhe të sigurisë së Kosovës për shkak të mungesës së Ushtrisë së saj dhe faktorit destabilizues institucional të minoritetit serb, ka marrë terren në rikthimin në agjendë të "çështjes së Kosovës" si një çështje që duhet të zgjidhet, duke e kthyer në tavolinën e bisedimeve si një problem të pazgjidhur në tërësi. Po ashtu, është investuar në forcimin e faktorit serb brenda Kosovës me "listën serbe" nën kontrollin e tij dhe nevojën që vetë Serbia ta aprovojë në fund të procesit pranimin e pavarësisë dhe shkëputjen e territorit të Kosovës, si një veprim të domosdoshëm që është praktik e së drejtës ndërkombëtare nga të gjitha shtetet nga të cilat shkëputen territore dhe formohen shtete të reja.
Ana e tjetër e errët e mosrealizimit të ridefinimit të territorial ndërmjet Kosovës dhe Serbisë do të ishte themelimi i paevitueshëm dhe ngritja e Asociacionit të Komunave Serbe brenda Kosovës, me ingerenca të njëjta të një Autonomie Substanciale sikurse që Kosova e kishte pas Luftës së Dytë Botërore në Federatën Jugosllave, me një përkrahje të fortë të Bashkësisë Ndërkombëtare dhe me premisa të shpërbërjes së rendit kushtetues të Kosovës në një periudhë afatmesme. Evitimi i një konstelacioni të tillë është me interes nacional për Kosovën dhe gjetja e modaliteteve të tjera që nënkupton edhe marrëveshje të favorshme për Kosovën në kuadër të ri definimit territorial me të cilën vetëm do të fitonte Kosova sipas parimeve mirë të trajtuara, do të ishte e pranueshme dhe me interes.
Pozita e Kosovës në marrëdhëniet ndërkombëtare lë shumë për të dëshiruar. Përkrahja e jashtëzakonshme dhe qenësore që e ka pasur përgjatë dy decenieve të mëparshme për lirinë dhe pavarësinë e saj nuk qëndron më në themelet e njëjta të qëndrueshme. Përkundër faktit që ende gëzon mbështetje në konsolidimin e shtetit të Kosovës, rrethanat e përgjithshme në konstelacionet ndërkombëtare nuk janë të njëjta. Gjatë kësaj kohe Bota ka ndryshuar, me këtë edhe interesat e fuqive të mëdha në marrëdhëniet ndërkombëtare.
Ndërmjetësues i vetëm në bisedimet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë është Bashkimi Evropian që, pavarësisht prej përpjekjeve për asnjanësi, disa shtete anëtare të saj refuzojnë ta pranojnë Kosovën si shtet, që ndikon edhe në marrëdhëniet e Kosovës me BE-në dhe të ardhmen e saj në këtë organizëm. Njohjet ndërkombëtare janë në vendnumërim për shkak të rrethanave ndërkombëtare dhe përfshirjes së tanishme të limituar të ShBA-së në këtë proces, meqë edhe njohjet dërrmuese të Kosovës janë rezultat i angazhimit të politikës së jashtme amerikane që nga fillet e këtij procesi me shpalljen e bashkërenduar të pavarësisë së Kosovës dhe njohjen e saj nga qeveritë e shteteve sponsoruese dhe nga shtytja e diplomacive të tyre, e jo i angazhimit të veçuar të ndonjë personaliteti kosovar apo të diplomacisë në ngritje të një shteti të ri si Kosova.
Politika e jashtme amerikane ka ndryshuar me administratën e re amerikane, e cila sjell konceptin e saj të një politike të jashtme të re. Kjo praktik nuk e përjashton as qasjen e Administratës së presidentit Trump, e cila i fitoj zgjedhjet me një politikë të fokusuar në çështjet e brendshme nën moton "Amerika e Para". Ky qëndrim më së miri e pasqyron edhe qëndrimin e saj ndaj politikës së jashtme në mbarë Botën, jo vetëm ndaj Evropës dhe Ballkanit e Kosovës në veçanti. Në fillet e saj politika e jashtme e Presidencës së Trump cilësohet me një vrojtim izolues duke u bazuar kryesisht në një politikë refleksive rreth çështjeve që prekin direkt Amerikën dhe politikën e brendshme të saj, sikurse marrëdhëniet me Rusinë, e cila është ende e vetmja fuqi e cila mund të rrezikojë ekzistencën e saj me raketa balistike ndërkontinentale, fakt i cili e ka vënë gjithmonë në rend të parë në interesat amerikane të sigurisë kombëtare dhe të politikës së jashtme. Këtë fërkim të përhershëm ndërmjet dy vendeve mund ta shfrytëzojë Kosova, në relacion me ndalimin e zgjerimit të influencës ruse në Ballkan. Si pjesë e këtij dimensioni nuklear është edhe interesi amerikan në kufizimin e fuqisë dhe mundësive nukleare të Koresë Veriore dhe Iranit. Temë tjetër që prek direkt në skenën e brendshme amerikane është edhe preokupimi i opinionit publik të saj me çrrënjosjen e ISIS-it dhe ekstremizmit fetar e akteve terroriste, me të cilat ShBA-të kanë pasur sukses të konsiderueshëm dhe të cilat kanë qenë pjesë e një tragjedie të brendshme, me të cilën Amerika ka pasur nevojë të ballafaqohet. Në këtë mozaik janë edhe Afganistani, Siria, Iraku dhe shtetet në fqinjësi të tyre, që ndërlidhen edhe me përplasjet e civilizimeve. Si pjesë e kësaj nxitjeje të brendshme janë edhe mbrojtja e interesave ekonomike amerikane përballë Kinës dhe disa shteteve evropiane, me instalimin shtesë të ngarkesave tarifore.
Evropa qëndron në rrethin dytësor të sferës së interesave gjeostrategjike amerikane, e ndërlidhur me sigurinë e përgjithshme evropiane nën moton shekullore "Një Evropë e lirë dhe e plotë". Përkundër faktit të një Trashëgimie të përfshirjes së politikës së jashtme amerikane në Evropë, në të cilën hyn edhe Ballkani e Kosova, ky angazhim tani është i qëndrueshëm vetëm në ato pika në të cilat interesat e tanishme ndërlidhen me instrumentet e përbashkëta të sigurisë me Aleatët Evropian, dhe kjo është NATO-ja. Në kontekstin e Kosovës, ky interes bëhet edhe më i fort për shkak të strukturës ushtarake të KFOR-it si pjesë e NATO-së që gjendet në Kosovë, duke e përfshirë edhe kontingjentin ushtarak amerikan. Prezencë amerikane ushtarake ka edhe në fqinjësi të Kosovës, në Bosnjë.
Një faktor tjetër që ka qenë i favorshëm për Kosovën është fakti se në fillet e krijimit të strukturës qeverisëse të Presidentit Trump, ka mbizotëruar elementi ushtarak me Gjeneralët në krye të institucioneve më të rëndësishme të sigurisë kombëtare dhe të politikës së jashtme amerikane. Në këtë bazë, të një trashëgimie ushtarake udhëheqëse amerikane, që ka qenë e përfshirë edhe në planifikimet ushtarake për çlirimin e Kosovës, është mbajtur relacioni i një vazhdimësie në politikën e jashtme amerikane ndaj Kosovës. Ky rrjet i gjeneralëve ka përfshirë Këshilltarin e Sigurisë Kombëtare H.R. McMaster, udhëheqës në emër të Presidentit të Këshillit të Sigurisë Kombëtare Amerikane, i cili është edhe organi më i lartë i ShBA-së për sigurinë kombëtare dhe politikën e jashtme amerikane, si dhe mpiksë në vete qëndrimin final të Presidentit të SHBA-së; James N. Mattis Sekretari i Mbrojtjes dhe personi më i besuar i Presidentit Trump; si dhe Shefi i Stafit të Presidentit Gjeneral John Kelly. Si ilustrim i rëndësisë së Këshillit të Sigurisë Kombëtare Amerikane duhet të theksojmë që në vartësi të tij në funksion të krijimin e politikës së jashtme dhe të sigurisë kombëtare amerikane janë të gjitha Sekretariatet dhe Departamentet kryesore, duke e përfshirë atë të Mbrojtjes, Shtabin e Komandantëve të Bashkuar, Departamentin e Shtetit, CIA dhe institucionet e tjera të rëndësishme.
Vendimet e tij janë obligative për këto Departamente dhe të gjitha institucionet e tjera shtetërore të ShBA-së. Strukturat e tjera më të ulëta janë të lidhura me Departamentet përkatëse, sikurse përfaqësuesit diplomatik të cilët nuk kanë asnjë rol në përcaktimin e politikës, përpos asaj të përfaqësimit të politikës zyrtare, të hartuara në strukturat e cekura më lartë.
Pas zëvendësimit të Këshilltarit të Sigurisë Kombëtare me John Bolton, i cili ka një qasje më fleksibile ndaj Kosovës, mbetet Gjenerali Mattis si përfaqësues në këtë organ dhe baza themelore e përkrahjes ndaj Kosovës. Për momentin, ai është shtylla që e mbanë gjallë kontributin, kontuinitetin dhe përkrahjen qenësore të politikës së jashtme amerikane ndaj Kosovës.
Përkrahja e një marrëveshje të mundshme të përbashkët paqësore për ridefinimin e kufijve nga ana e Këshillarit të ri Bolton, mund të shihet vetëm nën prizmin e një qasjeje më krijuese në gjetjen e një zgjidhjeje që do të ishte e favorshme për të dyja palët, e jo si ndryshim i kursit të politikës amerikane.
Mbajtja nën kontroll e sigurisë dhe stabilitetit të Kosovës dhe rajonit, mbetet ende mjeti themelor i përcaktimit dhe veprimit të politikës së jashtme amerikane ndaj Kosovës. Përkundër kësaj, një politikë amerikane qartazi e definuar për Ballkanin në përgjithësi, mbetet ende të definohet.
Këto fakte dhe ndryshimet konstante në skenën e politikë bërjes amerikane duhet të jenë vërejtje për veprim më efikas lobues të Kosovës në ShBA-të, duke përkrahur edhe formimin e financimin shumë më të madh të Qendrave sipas modelit Izraelit, si dhe angazhimin e institucioneve dhe kompanive përkatëse që merren me këtë veprimtari.
Si përfundim, bisedimet eventuale për ridefinimin e kufijve ndërmjet shteteve të Kosovës dhe Serbisë, duhet të realizohen me kujdes dhe me parime të aprovuara;nën monitorimin, mentorimin dhe miratimin amerikan; si dhe të bazohen në reciprocitetin shtetëror, përkufizim sipas sipërfaqes së njëjtë territoriale, respektimin e interesave nacionale të Kosovës, mbajtjen nën sovranitetin e saj të popullatë shqiptare kudo që jeton në Kosovë dhe bashkëngjitjen e popullatës shqiptare të Luginës së Preshevës.

**(Autori është historian, ekspert i politikës së jashtme amerikane ndaj Kosovës dhe Evropës Juglindore)**

Recension i librit të autorit Mrsci. Hamëz Ladrovci, me titull:"Çështja shqiptare përballë diplomacisë dhe gjeopolitik

# Libër me rëndësi të veçant



**Prof. dr. Eqrem ZENELAJ**

Sado që të kthehmi mbrapa në histori, Ballkani i sotëm (Gadishulli i Ilirisë së dikurshme), pra trojet etnike shqiptare, kanë qenë dhe kanë ngelur akoma si vatër e krizave politike-ushtarake dhe gjeopolitike, të fuqivë ballkanike , si dhe objekt i interesave dhe ndikimeve të fuqive të ndyshme të Europës dhe më gjërë.Ardhja e hordhive të ndryshme barbare, gotët vizigotët, avarët dhe së fundi fiset e shumta sllavët nga lindja, që nga shek IV, V, VI dhe VII, e trazuan në tërësi Ilirinë dhe popullsinë ilire.

Iliria së pari ra nën Perandorinë Romake(168.p.er.re.), pastaj me ndarjen e Perandorisë në dysh (395), pjesa dërmuese e trojeve etnnike shqiptare takoi Perandorisë së Lindjes apo Bizantit.Me dobësimin e Bizantit, u themeluan principatat të ndyshme sllave ne Ballkan, se pari u themelue shteti slloven apo Karantanija (Korushka), pastaj lindi shteti Kroat, pas tij shteti Bullgar, e pastaj më vonë u themelua edhe Principata e Rashkës (nga nemanjiqët), si dhe Shteti i Arbërit (Progoni e Dhimitri).

Me forcimin dhe forcimin e shtetit serb, sidomos në kulminacionin e fuqisë së tij ( në kohën e sundimit të Car Dushanit), Serbia arriti të pushtoi pothuaj tërë trojet shqiptare si dhe vendet tjera të Gadishullit Ballkanit(Ilirik).

Grindja dhe përçarja e vazhdueshme e princërve serbë dhe lufta e tyre për pushtet bëri që Perandoria e Car Dushanit të shkapërderdhet në tërësi(1335), nga e cila dolën disa principata shqiptare të pavarura, e ndër to: pricipata e balshajve, e kastriotëve, dukagjinëve, gropajve, zenevishtëve, muzakajve e etj.

Dalja e Perandorise Osmane në truallin e Europës futi tmerrin e principatave dhe shteteve të Europes, pasi që osmanet furishëm depërtonin në Europe, deri te dyert e Vjenës (1683), duke rrënuar, shkatërruar dhe pushtuar me radhë shtete dhe principata të Europes.Perandoria Osmane i nënshtroi edhe principatat shqiptare duke i shëndërruar ato në raporte vazale të osmanëve (1423.

Gjergj Kastrioti Skënderbeu (nga dera e kastriotëve), do të jet ai që do ja kthej namin krenarinë dhe pavarësine e Shqiperise, duke u krhyer në Shqipëri me 1443 dhe duke i bashkuar principatat shqiptare, i cili u quajt zyrtarisht Mbret i Shqipërisë dhe Princ i Epirit, apo zot i Shqipërisë *(Dominus Albaniae)*.Në kohën e Skënderbeut (1443-1468), Shqipëria përjetoi një pavarësi, një lulëzimin, si dhe u bë një digë e fuqishme e bllokimit të depërtimit Osman në Europë.

Gjegj Kastrioti-Skënderbeu ishte figura më markante politikeushtarake dhe diplomatike në Europën e shek XV-të të cilin Sulltan Muradi II e quajti Aleksandër *(Iskanderbeg)*, ndersa papët e Romës e quajten *"Atlet i Krishtit"*, sepse jo vetëm që e mbrojti Shqipërine për 25 vite me radhë nga pushtimi Osman por ishte njëherit edhe mbrojtës i civilizimit europjan për kohën e tij.me 1478, e tërë Shqipëria ra nën sundimin osman.

Me daljen në sipërfaqe të Austrisë së Dinastisë së Habsburgëve si fuqi ushtarake e politike europjane, dhe me dështimin e rrethimit të dytë të Vjenës nga Perandoria Osmane, më 1683, që rezultoi me Paqën e Karllovcit dhe nënshkrimin e Traktatit të Karllovcit më 1699 (neni XIII), Traktatit te Beogradit (1739), Traktatit te Sistovit ( 1791), tani më shqiptarët e robëruar sytë edhe shpresat e tyre i drejuan kah Vjena.

Është diçka shumë e dhimbshme, për tu shënuar dhe duhet shënuar, sepse në kohën kur kryeministër i Perandorisë Osmane ishte Shqiptari Sinan Pashai, i cili e pushtoi Györin (Hungari -Veriore që synonte dhe atakonte Vjenën në krye të ushtrisë Osmane, ndërsa në anën tjetër përballë ushrisë osmane ishte ushtria e Rudolfit të II-të, që udhehiqej per 13 vite me radhë(1593-1606), duke i bërë ballë me sukses mësymjeve dhe sulmeve osmaneve drejt Vjenës, ndërsa në krye të kesaj ushtrie habsburge qëndronte i fuqishëm dhe i pathyer, gjenerali shqiptar i Rudolfit II-të, Gjergj Dhimitër Basta.

Situata të tilla ka pasur shumë herë në historinë e dhimshme shqiptare, kur shqiptaret luftonin me njeri tjetrin, të rreshtuar në taporre të kunderta ushtarake, si që ishte "Lufta çlirimtare e Greqise", në të cilën luftë në njërën anë në ballë të ushtrisë greke, qëndronin komandantët e fuqishëm shqiptar(arvanitas), ndërsa në anën e Perandorise Osmane, qëdronin komandantë shqiptare, pra luftonte Perandoria Osmane me Greqinë, ndërsa në front mjerisht luftonin dhe vriteshin shqiptarët me shqiptarë.!

Në Europë pushtimet osmane luftonin dhe proklamonin luftën kundër të krishterëve si dhe luftë për përhapjen e islamit, ndërsa shtetet europjane luftën dhe mbrojtjen e tyre kundër depërtimit Osman e proklamonin si luftë për mbrojtjen e krishtërizmit dhe luftë për pengimit e depërtimit islam në Europë, por në fakt këto luftëra nga të dya anët ishin lufta për teritore, pasuri dhe pushtim.

Në këtë kutim, fuqitë europjane do të bashkëvepronin bashkë kundër Perandorisë Osmane, deri sa Vjena do ta kuptoi se të gjitha fitoret e fuqive europjane kundër Perandorisë Osmane, Rusia dëshironte ti kthej në favor të një politike gjeografike të saj dhe me tendenca të afirmimit dhe mbrotjes se interesave pan sllave në Europë dhe Ballkan, si dhe të formoj shtete zingjirore sllave ne Ballkan, të cilat do ti shërbejnë Rusisë si stete filiale gjeostrategjike të saj në të ardhmen.

Viti 1856 është viti i thyerjeve të mëdha në mes të fuqive europjane në njërën anë dhe të Rusisë Cariste në anën tjetër.Viti 1856 është pikërisht viti në të cilin linden hapur hasmëritë dhe interesat gjeopolitika në Europë.

**Libri i autorit Hamëz Lladrovci** me titull:" *Çështja shqiptare përballë diplomacisë dhe gjeopolitikës rusomadhe (1856-2018)"*, ka një rëndësi të veçantë shkencor dhe historik, sepse ky libër i trajton pikërisht këto rivalitete shkaqe e gjeopolitika qe nga gjeneza e tyre si dhe këto ngjarje, të cilat do të bëhen burim i shumë përplasjeve ushtarake e politike të mëtejm në Europë si dhe burim i ndarjes dhe aspiratave të gjeopolitikave të fuqive europjane.

Rusia Cariste do jetë e deklasuar dhe e indinjuar nga fuqitë e Europës per bashkimin e interesave dhe forcave të tyre kundër interesave dhe aspiratave gjeopolitike të Rusisë në Detin e Zi, Krime dhe më gjërë, ku me dispozitat e Traktatit të Parisit të vitit 1856, Rusia del një humbëse e madhe e cila me luftën e saj për Detin e Zi dhe Krimenë ajo bashkoi fuqitë europjane (Austrinë, Anglinë, Francën etj), kundër vehtës së sajë.

Traktati i Parisit i vitit 1856 do bashkoj fuqitë europjane të cilat do e formojnë të ashtuquajturin "Koncert europjan", ndërsa Perandoria Osmane do të merret nën mbrojtjen fuqive europjane, si dhe në të ardhmen asnjë luftë apo ndërhyrje ushtarak, as Rusia dhe askush nuk guxon të zhvillohet në Europë pa pëlqimin dhe miratimin e "Koncertit te Europës".

Traktati i Parisit i vitit 1856, Detin e Zi dhe Krimene i shpalli zona neutrale , pra zona të çmilitarizuara, ku asnjëra nga palët në konfliktit, pra as Rusia dhe as Perandoria Osmane nuk guxojnë të militarizojnë këtë zone, sepse Deti i Zi me Traktatin e Parisit (1856), u shpall i lirë dhe neutral, dhe det për lundrim të lirë ndërkombëtarë.

Te ky Traktat të vitit 1856, ***autori i librit Hamëz Lladrovci***, e gjenë dhe shtron me të drejtë zanafillën e gjeopolitikës Rusomadhe si dhe burimin e konflikteve ndërkombëtare, në Europë si dhe synimet e gjeopolitikës Ruse për Ballkanin.

***Autori Lladrovci,*** ka punuar me nje sens shkencor dhe sens analitik si njohës i marrëdhënjeve ndërkombëtare, duke shtjelluar dhe argumentuar shkencorisht në librin e tij, se kjo gjeopolitikë Rusomadhe-sllave-ortodokse, i ka rrënjët nga viti 1856 dhe ka vazhduar hapur apo fshehurazi, për zgjerim teritoresh dhe ndikim në marrëdhenjet ndërkombëtare, duke favorizuar dhe mbështetur idetë pansllave ruso-madhe, deri në ditët e sotme, pasoj e se cilës politike gjeografike bie mbi trojet shqiptare dhe Ballkanin, ku në vazhdimësi do të zhvillohen luftëra të përgjakshme, nëpër të cilat do të kaloj drama e tragjedisë shqiptare, sidomos me 1912/1913, ku nga ky llahtar dhe ky gjenocid serbë mbi popullsinë shqiptare, redaktori i gazetave të Vjenës Leo Freundlich, do hartoj dhe dërgoj nje apel fuqive të Europës, në emër të ndërgjegjës njerëzore dhe civilizimit për shpetimin e popullit shqiptar, nga vrasjet, dëbimet dhe nga asgjësimi total të cilin e synonte politika dhe makineria ushtarake serbo-sllavo-ortodokse, më 1912/1913, të cilin apell Freundlich e ka titulluar:"*Albanische Golgatha"* (Golgota shqiptare)..

***Autori i librit,*** **me** guxim dhe kopetencë shkencore zgjedh për hulumtim dhe analizë një periudhë të caktuar interesante kohore te gjeopolitikes Ruse , e cila daton nga viti 1856 e deri ne ditet e sotme.

Nëse i krahasojmë këto ngjarje dhe gjeopolitika të Rusisë Cariste të viteve 1856/1878 e deri te Revolucioni Socialist i Tetorit ne Rusim më 1917, me aktivitetin politik e ushtarak të ish-BRSS-se e sidomos të Federatës së sotme Ruse, si nxitëse dhe mbështetëse e konflikteve ndërkombëtare anti amerikane dhe antiperëndimore, pastaj me aneksimin Krimesë se Ukraines nga ana e Federatës Ruse të Putinit, dhe kundërshtitë, pengimin dhe destruktivitetin e Moskës zyrtare për pavaresinë e Kosovës dhe anëtarësimin e Kosovës në Organizata Ndërkombëtare apo pengimin për njohjet ndërkombëtare të shtetit të Kosovës, na duket se tani po përsëritet historia e njëjtë Ruso-madhe, sllavo-ortodokse dhe antishqipare, po përsëritet një gjeopolitikë e vjetër Ruse, me ringjalljen e politikës së vjetër dhe agresive pushtuese e dominuese te Moskës zyrtare të Putinit.

Shembujt më konkret të destruktivitetit politik, diplomatik e ushtarak e politik të Federatës Ruse në marrëdhënjet e sotme ndërkombetare pas periudhës së "Luftës së Ftohët", ishin dhe janë; aneksimi i Krimesë nga ana e Federatës Ruse, nxitja e separatistëve rus për separatizëm dhe kryengritje të rusëve në Ukrainë, pastaj përkrahja dhe mbështetja politike e ushtarake e rexhimeve diktatoriale si;rexhimi i Moamer Gadafit, Sadam Hyesinit, rexhimit të Mullahëve të Iranit, mbështetjen e rexhmit komunist diktatorial të Koresë Veriore e se fundmi mbështetja ushtarake e rexhimit kriminel të diktatorit Bashar el Asad, jane fakte dhe dëshmi të prekshme të gjeopolitikës dhe hegjemonizmit Ruso-madh, i cili rexhim angazhohet vazhdimisht të ketë sa më shumë vatra krizash antiperëndimore, antiamerikane dhe anti NATO, në mënyrë që të rikthej poziten e vet te humbur, si superfuqi botërore, me shuarjen e Paktit të Varshavës dhe shpërbërjen e ish-BRSS-së.

Politika e jashtme e Moskës zyrtare është e orjentuar në kërcënimin e shteteve të ish bllokut socialist, ku disa nga ato ( Polonia, Hungaria, Bullgaria, Rumunia, Mali i Zi, Kroacia, Sllovenia etj), madje janë anëtarësuar në aleancën e NATOS, kështu që Putini pos kërcënimit ushtarak të vazhdueshëm ndaj Ukrainës duke nxitur dhe mbështetur ushtarakisht separatistët rus në Ukraine, Federata Ruse vazhdimisht kërcënon edhe vendet e baltikut(Letoni, Estoni, Lituani), me ndërhyrje ushtarake, me anë të prezencës dhe manovrave ushtarake atje duke demonstruar një arsenal të madh ushtarak e bërthamor, në mënyrë që të demonstroj forcën ushtarake dhe superioritetin ushtarak ndërkombëtarë, e bile së fundi edhe duke paralajmëruar nga ana e Putinit në mënyrë publike në një konferencë për shtyp edhe mundësinë e një*"Lufte të Tretë Botërore".*

Rusia e Putinit tani më sytë i ka tek Serbia, e përmes saj në realizimin e interesave të saj në Ballkan, gjë që me politikën e saj të jashtme, Rusia e Putinit, është e përzier direkt dhe indirekt në marrëdhënjet e Sërbisë me fqinjët dhe faktorin ndërkombëtar.Me një fjalë atë që nuk arriti ta realizoj Putini tek shtetet sllave në Ballkan

ës rusomadhe (1856-2018)"

# ë shkencore dhe historike




nga Sllovenia e deri te Mali i Zi, ai tenton ta realizoj këtë strategji politike dhe ndikim të Federatës Ruse te Serbia, si dhe me anë të Serbisë, Federata e sotme Ruse, tenton ta pengoj anetaresimin e Serbisë në NATO dhe në Unionin Europjan.Pra si që e vëren edhe vet autori ***Hamëz LLadrovci,*** në këtë liber, se Moska zyrtare, ka qenë dhe mbetet burimi i vërtetë i shovenizmit serb si dhe vendburim i projekteve sllavo-ortodokse e pushtuese të fqinjeve ballkanas , pra Moska zyrtare, ka qenë dhe mbetet burimi dhe inspirim kryesor i një projekti të vjetër sllavo-ruso-serbo-ortodoks, si dhe burim i një gjeopolitikë, Rusomadhe, e cila politike nga vitet 1876/77 dhe 78 e deri më sot, ka sjelle na vazhdimësi tragjedi historike-kombëtare shqiptare, si dhe copëtimin e vazhdueshëm të trojeve etnike shqiptare, nga Traktati Shën Stefanit (03.03-1878), Kongresi i Berlinit (1878), deri te Konferenca e Ambasadorëve në Londër me 1912/1913, ku nga 88.000 km2 qe kishin IV vilajetet shqiptare, Konferenca e Londrës njohu një Shqipëri Principatë me 28 km2.

Kështu vendosën edhe Konferencat e Parisit(1919, 1946), Komisioni i Badinterit, Konferenca e Rambujesë, e deri te *Pakoja e Ahtisarit* , të tjerët vendosën për fatet e shqiptarëve ndërsa vet shqiptarëve asnjëherë nuk iu njoh e drejta e vetëvendosjes si komb, sikurse që iu njoh sllavëve në Ballkan dhe popujve të tjerë të botës e parapare edhe me 14 pikat e Presidentit Villson, pastaj të ideve dhe programeve progresive filozofike e socio-politike , të autorëve të ndryshëm para Luftes së I-rë Botërore, kjo e drejtë dhe ky parim në fakt është edhe njëri ndër parimet themelore të Kartës së Kombeve të Bashkuara.

***Hamëz Lladrovci*** e studjon e hulumton dhe e bënë faktike këtë politikë agresive dhe destruktive antishqiptare të Federatës Ruse, e cila ngelë si pengesa kryesore e pajtimeve dhe bisedimeve Serbi-Kosovë, si dhe pengesë dhe bllokadë për avancimin e Kosovës në marrëdhënje ndërkombëtare dhe pengesë, për anëtarësim të Kosovës në Interpol, UNESCO, OKB, Këshillin e Europës si dhe në organizatat tjera ndërkombëtare, aty kudo ku ka ndikim Federata Ruse.

***Autori, Lladrovci,*** për ta realizuar këtë projekt shkencor dhe për ta publikuar si libër, ai ka hulumtuar dhe ka punuar mbi dy vite nëpër arkivat e Brukselit, Parisit, Vjenës dhe sidomos të AQSH në Tiranë.Një pjesë të këtij punimi, ai së pari ai e punon si punim diplome të Masterit dhe pas mbojtjes ia shtonë edhe gjysmën tjetër dhe e kompleton hulumtimin e tij shkencor si libër.

***Hamez Lladrovci***, është pjesëtar i familjes atdhetare Lladrovci (Kushëri i Dëshmorit të Kombit Fehmi LLadrovci).I brymosur me ide patriotike, Hamza merr pjese në demonstratat shqiptare kundër rexhimit Jugosllav, për liri dhe të drejta kombëtare, kështu që një një demonstratë të tillë kundër rexhimit Jugosllv, të vitit 1991.Hamez Lladrovci, nga policia serbe plagoset rëndë në këmbë, për tu shëruar në Belgjikë, duke qëndruar pastaj për 7 vite me radhë atje. Qëndrimi në Belgjikë ja mundëson atij njohjën e Gjuhës Frënge e cila do ti shërbëje për hulumtime arkivore në Belgjikë dhe Francë, si dhe njohjen dhe kuptimin e përmbajtjeve të dokumenteve të ndryshme arkivore, në Gjuhën Frënge.

Prandaj përzgjedhja dhe përkushtimi i kësaj tematike të rëndësishme historike e kombëtare nga autori ***Hamëz Lladrovci,*** nuk ishte as e një rastësie dhe as një aventurë shkencore, por përkundrazi, për autorin, ka qenë një obligim moral shkencor dhe kombetarë, që ia parashtroi vetës së tij , për të hulumtuar dhe për ta ndiquar sado pak një segment të caktuar kohor dhe një periudhë shumë të rëndësishme në marrëdhënjet ndërkombëtare (1856-2018), nëpër të cilën janë pëcaktuar fatet e kombit shqiptar me vdnime arbitrare dhe të padrejta të qendrave të vendosjes me anë të konferencave dhe kongreseve të ndryshme nderkombëtare, prapa të cilave në dëm të interesave kombëtare shqiptarë dhe ne favor të qarqeve sllavo-serbe dhe ortodokse ballkanike veppronte Rusia me politikën diplomacinë dhe gjeopolitikën e saj.

***Hamëz Lladrovci*** këtë libër të tij e përfundon me një konkluzion përmbajtësor ndërsa fare në fund të librit na ofron një shtojcë interesante me disa dokumente arkivore të rëndësishme kombëtare, të pa publikuara më parë, të cilat ia rrisin vlerën shkencore dhe faktografike këtij libri.

Për ti dhënë kredibilitet të besueshëm shkencor këtij libri, autori ka ndërmarr një sërë udhëtimesh jashta Kosovës, nëpër disa arkivedhe biblioteka të vjetra dhe të njohura europjane, sidomos në Belgjikë, Francës, Austri si dhe në Arkivin Qëndror të Shtetit(AQSH), në Tiranë.

Disa nga dokumentet me vlerë shkencore, historike e kombëtare qe autori na i servone në këtë liber janë dokumente arkivore të kohës së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Lidhjes së Pejës, Kuvendit të Dibrës, nga raportet e konsujve të huaj, si dhe dokumente e të dhëna të tjera autentike e origjinale, të cilat ja shtojnë besueshmërinë shkencore këtij libri dhe e bëjnë të kapshëm librin për lexuesin.

Nga AQSH në Tiranë vlejnë të përmendim faksimile, vendime dhe të dhëna sekrete të organeve dhe institucioneve partiake e shtetërore të Shtetit Shiptar në kohën e Enver Hoxhës, e sidomos vendime të rëndësishme dhe të dhëna të pa njohura, sekrete dhe tejet interesante të Burosë Politike të Komitetit Qendror të Partisë së Punë së Shqipërisë, të Kuvendit Popullor të Shqipërisë, si dhe të strukturave tjera të larta shtetërore e partiake, sidomos në peiudhën pas Luftës së dytë Botërore, që tregojnë pë vlimet politike e ushtarake ne Shqipëri si dhe raportet Enver-Stalin dhe Enver Hrushqov, ku të një rëndësie janë qëndrimet dhe vendimet e organeve partiake e shtetërore të Shqipërisë për gjykimin e akteve agresive të BRSS-së dhe të Paktit të Varshavës, të ndërhyrjes ushtarake në Hungari dhe Çekosllovaki, por edhe vendimin e guximshem të Shqipërisë për daljen e saj nga Pakti Varshavës.

***Libri i Hamëz LLadrovcit*** me titull:" *Çështja shqiptare përballë diplomacisë dhe gjeopolitikës rusomadhe (1856-2018)",* ka një meritë dhe rëndësi të veçantë, si për lexuesin kombëtarë ashtu edhe për lexuesin e huaj.

Se fundi autorit të librit i urojmë suksese të mëtejme në punën dhe publikimet tjera shkencore, ndersa këtij librit i dëshirojme përhapje të gjërë me dëshireën që ky libë të jetë i dobishëm dhe interesant si për lexuesin kombëtarë ashtu edhe atë ndërkombëtar.

Libra të tilla si ky i autorit Hamëz Lladrovci, meritojnë një vemendje dhe mbështetje finaciare nga institucionet shtetërore Kosovë-Shqipëri si dhe për tu përkthyer edhe në gjuhët e huaja!

E rrallë

## Nusja merr një ambulancë për të thënë "po"!



Nuk ka karrocë ëndrrash. Asgjë e konvertueshme. Një nuse zgjodhi një ambulancë private (e plotësuar me shenjën 'Emergenza sposi', me fjongo dhe sirena) për të shkuar në sallën e bashkisë për të thënë "po". Ngjarja ndodhi në Boscoreale në Napoli. Skena u xhirua nga kalimtarë kureshtarë dhe jobesimtarë. Videoja e mbërritjes së nuses, e cila u bë virale në mediet sociale, nxiti polemika të nxehta.

## BARSOLETA E DITËS



**Babai: Bir, a i ke ditur pyetjet në provim?**
**Djali: Po, babi.**
**Babai: E pse ke rënë nga provimi, biri im i dashur?**
**Djali: Nuk i dija përgjigjet, babi.**

Kino ABC Prishtine

**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**

**Vetem gjate vikendit në ora 16:00**

### " INCREDIBLES 2" 3D

I Animuar/Aksion/Aventure; 1 ore 58 min

**Rolet:** Holly Hunter, Craig T. Nelson, Sarah Vowell, Huck Milner, Samuel L. Jackson, etj.

**Regjia:** Brad Bird





**Në ora 18:20**

### "FUTURE WORLD"

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

**Rolet:** James Franco, Suki Waterhouse, Milla Jovovich, Lucy Liu, Jeffrey Wahlberg, Snoop Dog, etj.

**Regjia:** James Franco

**Në ora 20:00**

### "ANT-MAN AND THE WASP" 3D

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 1 orë 58 min

**Rolet:** Paul Rudd, Evangeline Lilly, Michael Pena, Michael Douglas, Michelle Pfeiffer, Laurence Fishburne, etj.

**Regjia:** Peyton Reed





**Në ora 22:00**

### "LOVING PABLO" (R)

Biografi/Krim/Drame; 2 ore 03 m

**Rolet:** Javier Bardem, Penélope Cruz, Peter Sarsgaard, etj.

**Regjia:** Fernando León de Aranoa

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**

FOTO E DITES



Ushtarët në Meksikë shkatërrojnë një plantacion marijuanë pranë qytetit La Rumorosa në Tecate. /AFP/

E jashtëzakonshme

## Mijëra tatuazhistë zbarkojnë në Moskë për panairin e tatuazhit



Mijëra bletë "pushtuan" pjesë të "Times Square" duke krijuar panik te turistët dhe kalimtarët. Bletët u vendosën më pas në kioskën e një shitësi në "43 Street and Broadway". Masa e insekteve ishte aq e dendur sa ulte nga pesha pjesë të çadrës së shitësit që shërbente "hot dog". Incidenti zgjati rreth një orë para se ekipi i posaçëm i Departamentit të Policisë së Nju Jorkut t'i merrte bletët dhe t'i dërgonte diku tjetër.



**DASHI**
Kritikat e bëra ndaj jush po japin rezultate pozitive në punën tuaj sepse keni marrë me të mirën prej tyre dhe e keni vënë në zbatim.



**DEMI**
Keni kuptuar që jeta është e përbërë edhe nga gjëra të tjera përveç punës dhe po u dedikoheni këtyre gjërave tërësisht sot.



**BINJAKËT**
Iniciativat që do të ndërmerrni sot do t'ju japin shumë zgjidhje personave afër jush. Dikush do t'ju shpreh falënderimet në një mënyrë të ngrohtë.



**GAFORRJA**
Një problem konstant që nuk po ju lë të avanconi duhet ta zgjidhni nga rrënjët sepse do të vazhdojë t'ju torturojë për një kohë të gjatë.



**LUANI**
Sot keni vënë në dukje një anë të panjohur tuajën dhe mjaft të ndjeshme. Jeni kokëfortë në shumicën e rasteve dhe nuk i tregoni ndjenjat tuaja.



**VIRGJERESHA**
Dikush do të kërkojë sqarime nga ju se përse gjatë kësaj kohe nuk keni shfaqur përkushtimin e duhur. Është diçka momentale që do të sqarohet.



**PESHORJA**
Këtë periudhë keni zgjedhur një mënyrë kontradiktore për të qenë në vëmendje, vetëm nëpërmjet heshtjes tuaj dhe injorimit të personave të caktuar.



**AKREPI**
Keni bërë ç'është e mundur për të sqaruar gjërat me një person të caktuar, por përsëri ju kanë keqkuptuar.



**SHIGJETARI**
Sot mund t'ju lindin probleme me familjarët sepse nga punët e tepërta do të harroni disa ngjarje dhe situata që nuk mund të harrohen.



**BRICJAPI**
U keni dhënë hapësirën e duhur personave të duhur, por nuk jeni shprehur për këtë gjë. Do të keni mirënjohjen e tyre në të ardhmen e afërt.



**UJORI**
Të ecni përpara në karrierën tuaj në këto momente paraqitet mjaft e vështirë. Ka rrethana të caktuara që nuk ju lejojnë të bëni atë që doni.



**PESHQIT**
Sot doni të ndryshoni rrugën që keni marrë për të tejkaluar një problem të caktuar. Duhet të merrni dhe mendimin e të tjerëve.

# Familja Beckham feston në jahtin e Elton Johnit



Futbollisti i njohur David Beckham, së bashku me gruan, Victorian dhe fëmijët janë duke kaluar pushimet në jahtin e këngëtarit Elton John. Ata festuan edhe ditëlindjen e djalit të tyre Romeos. Gjatë tërë kohës shihen të lumtur duke shijuar detin në Jug të Francës, po ashtu duke notuar e duke shkrepur fotografi.



# Irina Shayk pushton tapetin e kuq me Donatella Versacen



Irina Shayk dhe Donatella Versace dominuan në tapetin e kuq të 75-vjetorit të Venice Film Festival. Donatella është një ikonë e modës dhe njihet për stilin e jashtëzakonshëm pasi zotëron shtëpinë luksoze të modës "Versace". Ajo siguroi vëmendjen e të gjithëve në premierën e filmit "A Star Is Born" që luhet nga Lady Gaga dhe Bradley Cooper. Stilistja e famshme 63-vjeçare dukej mahnitëse, e veshur me një fustan të kuq, derisa arriti në ngjarjen me supermodeluesen Irina Shayk.



# Nicole Scherzinger përfundon verën me një veshje të mrekullueshme

Nicole Scherzinger ka qenë duke i shijuar pushimet kohët e fundit në Detin Mesdhe. Këngëtarja më në fund arriti në vendlindjen e saj në Los Angelos, duke u veshur e gjitha në të bardhë. Ajo shkoi për pushime pas ditëlindjes së saj.

# Justin Bieber këtë herë del pa të fejuarën

Justin Bieberi është parë duke dalë nga hoteli në fundjavën që lamë pas në Beverly Hills, California, këtë herë pa të fejuarën e tij. Këngëtari 24-vjeçar kishte të veshur një bluzë me ngjyrë të kaltër të kombinuar me një kapelë, teksa po mbante në dorë edhe një kitarë. Një natë më parë Justini dukej shumë i lumtur krah Hailey Baldwin, në një darkë romantike.






Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

| | |
|---|---|
| FYLDE - SALFORD CITY | 1 |
| BROMLEY - BARNET | 1 |
| DOVER ATHLETIC - EBBSFLEET | 2 |

# Challandesi: Luajmë për fitore ndaj Azerbajxhanit dhe Ishujve Faroe

Trajneri zviceran i Kosovës, Bernard Challandes, është optimist se Kosova mund t'i mposhtë dy kundërshtarët e shtatorit në Ligën e Kombeve: Azerbajxhanin dhe Ishujt Faroe. Challandesi ka konfirmuar se gjasat janë shumë të mëdha që Kosovës t'i bashkohen dy yjet e futbollit, Meritan Shabani dhe Florent Hadergjonaj

EPOKA E RE Liridon ZEQIRI



Prishtinë, 3 shtator - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll do t'i zhvillojë dy ndeshje në Ligën e Kombeve më 7 shtator në Baku kundër Azerbajxhanit dhe tri ditë më vonë në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë ndaj Ishujve Faroe.

Trajneri i Kosovës, Bernard Challandes, ka thënë të hënën në konferencë për medie se nëse mendohet se Kosova është favorite, atëherë ky do të ishte një gabim shumë i madh. Trajneri zviceran ka lavdëruar skuadrat kundërshtare dhe ka apeluar që të harrohen rezultatet miqësore, përfshirë edhe fitoren ndaj Shqipërisë. "Po punoj të kemi një ekip të mirë jo vetëm për këtë lojë, por edhe për të ardhmen. Kosova do të rritet dhe ka një të ardhme jashtëzakonisht të mirë. Nuk pëlqej të fiksoj rezultate, sepse nganjëherë fitoret sikur që patëm kundër Shqipërisë mund të jenë të rrezikshme dhe mund të vetëkënaqemi e kjo nuk guxon të na ndodhë. Ne patëm disa ndeshje miqësore me rezultat të mirë, por kjo nuk bën të na mashtrojë. Sa i përket Azerbajxhanit, mendoj se është një skuadër e fortë, me agresivitet dhe është e ranguar më së larti në këtë grup. Prandaj duhet të kemi kujdes. Nuk ka favorit absolut, prandaj do të bëjmë më të mirën e mundshme", ka thënë Challandes, i cili ka bërë me dije se Besar Halimi do të grumbullohet për ndeshjen ndaj Ishujve Faroe, pasi nuk e ka përgatitjen e duhur fizike për ndeshjen ndaj Azerbajxhanit.

Mbrojtësi Kastriot Dërmaku është futbollist i ri në Përfaqësuan e Kosovës. Trajneri Challandes ka thënë se me ardhjen e tij problemet në mbrojtje mund të evitohen. "I kemi disa probleme në mbrojtje, por Kastrioti do të na ndihmojë. Ai ka luajtur gjithsejtë 30 ndeshje në Itali, Serinë C dhe Serinë B dhe me të vërtetë që është i pazëvendësueshëm. Ai është në formacionin e mbrojtësve në Itali dhe atë e kemi thirrur ta integrojmë në grupin tonë si dhe më pas të shohim se a do të na japë ndonjë gjë pozitive, të cilën e presim", ka shtuar ai. Në fund Bernard Challandes ka shfaqur optimizëm se Kosovës do t'i bashkohen Meritan Shabani dhe Florent Hadergjonaj. "Jam në kontakt me Hadergjonajn që ishte në pritje të ftesës së Zvicrës, por që nuk e mori. Nga ky moment do të provoj ta sjell në kombëtaren tonë. Kam kontakte të mira edhe me agjentin Erdin Shaqiri (vëllai i Xherdanit). Me Shabanin po shihet se ka disa probleme me Kombëtaren e Shqipërisë, por familja e tij e ka marrë një vendim. Kam biseduar me babanë dhe vëllanë i tij. Tani do t'i lëmë pak kohë që të vendos se a do të na bashkohet", ka deklaruar Challandes. Ndeshjen ndaj Azerbajxhanit Kosova e zhvillon më 7 shtator, me fillim nga ora 18:00, kurse ndeshja e dytë ndaj Ishujve Faroe zhvillohet më 10 shtator, me fillim nga ora 20:45.

# Feronikeli shkarkon Starovën, rikthen Ramadanin



Drenas, 3 shtator - Zekirija Ramadani është rikthyer sërish në krye të skuadrës së Feronikelit nga Drenasi. Trajneri nga Maqedonia në postin e trajnerit e zëvendëson Sulejman Starovën, i cili u shkarkua një ditë më parë edhe përkundër faktit se e fitoi ndeshjen ndaj Ballkanit. "Klubi njofton që ka arritur marrëveshje me trajnerin e mëparshëm të Feronikelit, Zekirija Ramadani, i cili do ta udhëheqë klubin në luftën për titull. Marrëveshja me Ramadanin është arritur dhe ai do ta fillojë drejtimin e klubit brenda pak ditësh. Me këtë marrëveshje klubi synon t'i rikthejë ditët e arta, meqë Zekirija Ramadani i njeh lojtarët, pritjet dhe nivelin e përgatitjes së skuadrës sonë dhe e di që synimi kryesor i klubit është marrja e titullit të kampionit. Ne i dëshirojmë suksese trajnerit tonë të ri dhe mbesim me shpresë që i njëjti do t'i mbështesë dhe do ta nxjerrë më të mirën nga lojtarët tanë", thuhet në njoftimin e Feronikelit.

## SHKURT

### Basha: Tek Arisi për shkak të kombëtares

Mesfushori nga Kosova, Migjen Basha, ka bërë me dije se e ka zgjedhur skuadrën e Arisit për ta ruajtur vendin në Kombëtaren e Shqipërisë. "Sigurisht se kalimi te Arisi është një motivim shumë i madh. Kam pasur oferta nga disa klube, por rrezikoja ta humbja kombëtaren. Synimi im është ta mbaj kombëtaren deri në maksimumet e viteve të mia. E kam pranuar Arisin për të qenë pranë kombëtares", ka thënë Basha. Duke folur për transferimin e mundshëm të Mërgim Mavrajt në skuadrën e Arsisit, Basha ka deklaruar: "Varet nëse do të bien dakord të dyja palët. Di që ka interes si nga ana e klubit, po ashtu edhe nga ana e lojtarit".

### Zidane mund ta marrë drejtimin e Romës

Qëndrimi i Eusebio Di Françesko po vihet në dyshim te skuadra e Romës pas rezultateve zhgënjyese në këto javë të para të Serisë A. Ndërkohë që, sipas asaj që bën me dije "Calciomercato", vendin e tij mund ta zënë disa emra të mëdhenj trajnerësh të cilët tani janë të lirë. Dhe një nga emrat më favorit për ta marrë drejtimin e skuadrës kryeqytetase është ish-tekniku i Realit të Madridit, Zinedine Zidane.

### FIFA zbulon futbollistët për çmimin e vitit

Tre kandidatët për ta fituar çmimin e lojtarit më të mirë sipas FIFA-s janë zbuluar. Votimi është bërë nga fansat, gazetarët, trajnerët e kombëtarëve dhe kapitenët e kombëtarëve. Njëri prej këtyre, Cristiano Ronaldo, Mohamed Salah dhe Luka Modriqi, do ta fitojë çmimin prestigjioz më 24 shtator. Në këtë listë kësaj radhe nuk është Lionel Messi.

### Danimarka rrezikon përjashtimin nga "Euro 2020"

Futbolli dhe paratë janë sinkronizuar më shumë se asnjëherë në dekadat e fundit duke e kthyer sportin më popullor në arenën e një biznesi fitimprurës që gjeneron miliona, por rastet kur është cenuar kombëtarja kanë qenë të pakta. Këtë radhë diskutimet për kontrata dhe sponsorizimet u rikthyen në vëmendje me rrezikun që përballet Danimarka për t'u përjashtuar nga "Euro 2020". Federata e vendit skandinav po kërkon të zëvendësojë përkohësisht disa yje të ekipit si Christian Eriksen, pasi negociatat për termat financiarë me kompanitë sponsore dështuan sërish. Nëse Federata Daneze nuk arrin të rekrutojë lojtarë të rinj për ndeshjet ndaj Sllovakisë dhe Uellsit, atëherë mund të përjashtohet nga turneu kontinental që zhvillohet pas dy vjetësh. Lojtarë si Christian Eriksen kërkojnë kontrata individuale dhe jo kolektive për ta mbajtur logon e tyre në kombëtare.

## Pas Alonsos, nga McLareni largohet edhe Vandoorne

Madrid, 3 shtator - Pas largimit të Fernando Alonsos, që vendosi të tërhiqet nga garat e Formulës 1, drejtuesit e makinës McLaren vendosën ta largojnë edhe pilotin Stoffel Vandoorne, që në fund të këtij sezoni do të jetë i papunë. Vendin e tij te makina britanike do ta zërë piloti Lando Norris, një 18-vjeçar që këtë sezon ka qenë piloti rezervë i McLarenit. Vandoorne ka mbërritur te McLaren në vitin 2013. "Largohem pas pesë vjetësh të jashtëzakonshëm, fantastikë për mua", ka thënë piloti belg. Ndërsa Zak Brown, shefi i McLarenit, ka deklaruar: "Më vjen keq që marrim këtë vendim, por nuk patëm mundësi t'i ofrojmë një makinë të mirë. Mirëpresim Norris, i ri dhe me shumë talent. Falënderoj skuadrën McLaren për këtë mundësi që më jep dhe shpresoj të jap më të mirën në pistë. Një shans i artë për mua, ndaj do të jap më të mirën", u shpreh Nando Norris pas emërimit pilot i parë te makina britanike. Piloti tjetër i



kësaj makine është Carlos Sainz, që ka zënë vendin e Fernando Alonsos.

# Josa: Në Shqipëri futbollistët s'të dëgjojnë, në Kosovë të respektojnë



**Prishtinë, 3 shtator** - Mirel Josa vijon punën me skuadrën e Prishtinës në Superligën e Kosovës. Në dy ndeshjet e para të luajtura, skuadra bardheblu ka siguruar dy fitore, duke përmbushur të gjithë pritshmëritë. Në një prononcim për "Radio Kosovën", trajneri 55-vjeçar ka zbuluar se në Kosovë lojtarët janë më të vëmendshëm dhe më të respektueshëm se në Shqipëri. "Nëse në Shqipëri u flet për një çerek ore lojtarëve në dhomat e zhveshjes apo edhe më shumë, ata më pas të thonë 'hajde more çfarë thotë ky', kurse këtu të dëgjojnë me vëmendje dhe të respektojnë. Shqipëria ka shumë vjet që është pjesë e UEFA-së, kurse Kosova vetëm dy vjet. Ecuria juaj ka përqindje shumë të lartë në krahasim me ecurinë e zhvillimit të futbollit shqiptar. Këtu duhet përmirësuar infrastruktura e të gjitha stadiumeve e cila po rregullohet. Shqipëria ka pasur shumë vjet në tranzicion. Futbollistët nga Kosova kanë ardhur dhe kanë dhënë kontribut duke pasur urë lidhëse Shqipërinë për Evropë", ka thënë Josa.

# Serena Williamsi dhe Rafael Nadali kualifikohen në çerekfinale




**Londër, 3 shtator** - Vijon marshimi i tenistes amerikane Serena Williams në grand slam të US Open, që në raundin e katërt të turneut njujorkez mundi 2-1 estonezen Kaia Kanepi (6-0, 4-6, 6-3). Edhe pse tenistja 36-vjeçare luajti me hope, sërish Serena ishte superiore në fushë, duke e merituar fitoren dhe siguruar një vend në çerekfinale. Motra e vogël Williams konsiderohet favorite pas eliminimit të disa prej tenisteve më të mira aktualisht në botë, ndërkohë që në çerekfinale do të luajë ndaj numrit tetë në botë, çekes Karolina Pliskova.
Pliskova në raundin e katërt fitoi 2-0 ndaj australianes Ashleigh Barty (6-4, 6-4), një përballje ku çekja tregoi një nivel të mirë dhe e komandoi ndeshjen, duke fituar nga një "game" me shërbimet e rivales në çdo set. Në çerekfinale shkon edhe tenistja tjetër amerikane Sloane Stephens, kampione në fuqi e US Open, që mundi 2-0 (6-3, 6-3) belgen Kiki Bertens. Një ndeshje e mirë e Stephensit, që synon ta mbrojë titullin, ndërkohë që në çerekfinale do të luajë ndaj letonezes Anastasija Sevastona. Ajo mundi 2-1 ukrainasen Elina Svitolina (6-3, 1-6, 6-0). Edhe tenisti Rafael Nadal u kualifikua në çerekfinalet e turneut US Open, pasi e mposhti gjeorgjianin Basilashvili. Nadali fitoi 6-3, 6-3, 6-7 dhe 6-4 për ta vijuar aventurën në Grand Slamin e fundit të vitit. Spanjolli, i cili është kampion në fuqi i US Openit, do të përballet në çerekfinale me austriakun Dominic Thiem. Rafael Nadali e ka fituar tri herë turneun US Open në vitet 2010, 2013 dhe 2017.

## SHKURT

### Del Piero: Modriqi e meritoi çmimin e UEFA-s

Përballë të gjithë zërave te Juventusi që e cilësonin Cristiano Ronaldon më të mirin e sezonit të kaluar në UEFA, një legjendë e futbollit italian dhe Juventusit si Alesandro Del Piero doli kundër. Ish-kapiteni i kampionëve të Italisë ka thënë se Luka Modriqi e meritonte vlerësimin maksimal, ndërsa Ronaldo duhej të ishte i pranishëm në ceremoninë e Montekarlos. "Të kesh inat se nuk e more çmimin është diçka që qëndron, por prezantimi është tjetër gjë. Nëse Ronaldo do të shkonte në ceremoni nuk do të kishte asnjë polemikë. Për mua ishte shumë i drejtë vendimi për t'i dhënë vlerësimin Luka Modriqit, për atë që ka dhënë në fushën e lojës edhe pse kjo nuk i hoq meritat Ronaldos", ka thënë Del Piero. "Sistemet e mbrojtjes në futbollin italian janë mes më të mirëve, për të mos thënë numri 1 në botë. Por zakonisht Ronaldo ecën më mirë në pjesën e dytë të sezonit, ndërsa në Ligën e Kampionëve është krejt ndryshe pasi ka më shumë hapësira", ka deklaruar Del Piero.

### Toure: Ja pse u riktheva te Olympiacosi

Yaya Toure ka bërë me dije arsyen e transferimit në Olympiacos. Mesfushori nënshkroi me klubin grek pas largimit të tij si futbollist i lirë nga Manchester City. "E kisha bërë një premtim në vitin 2006 kur jam larguar dhe jam i lumtur që e kam realizuar. Kisha oferta edhe nga klube të tjera evropiane, nga Azia dhe ShBA-ja, por kam vendosur ta dëgjoj zemrën", ka thënë Toure.

### Villarreali kërkon Marchision

Villarreali është klubi i fundit që ka treguar interesim për Claudio Marchision. Mesfushori u largua nga Juventusi gjatë verës, kurse interesim për të kishin shfaqur edhe Zeniti, Befica dhe Porto. Skuadra spanjoll e dëshiron Marchision si zëvendësues të Santiago Caseres, i cili do të mungojë tre muaj për shkak të lëndimit.

### Donnarumma dëshiron suksese me Milanin dhe Italinë

Gianluigi Donnarumma ka shprehur dëshirën të kthejë Milanin dhe Përfaqësuesen e Italisë në majat e futbollit botëror. Portieri italian ka thënë se kuqezinjtë kanë një skuadër shumë të mirë dhe shpreson në një vend që dërgon në fazën e grupeve të Ligës së Kampionëve për sezonin e ardhshëm. "Jemi një grup i shkëlqyer", ka thënë Donnarumma për "Sky Sport Italia". "Ne donim shumë suksesin ndaj Romës. Objektivi ynë është të kthejmë Milanin aty ku e ka vendin, që është Liga e Kampionëve dhe ne do të bëjmë gjithçka për ta arritur këtë. Gjithmonë i pranoj kritikat, jam djalë i qet që jep gjithçka në stërvitje", ka deklaruar ai. "Leonardo, Maldini dhe Kaka? Është shumë emocionuese t'i shikosh ata së bashku. Fillimisht ata të fusin paksa frikën, por pastaj të japim një motiv të madh për të bërë mirë". "Skuadra kombëtare? Është gjithmonë mirë për t'u kthyer këtu. Ne duhet të bëjmë gjithçka për ta kthyer Italinë në rrugën e duhur", ka shtuar Donnarumma.

### Reali monitoron Cutronen

Patrick Cutrone pritet të ketë një sezon si protagonist këtë vit te Milani dhe këtë gjë e konfirmoi ndeshja me Romën, ku vendosi fatin e takimit, por zërat e merkatos rreth tij janë të destinuar të shtohen. Mësohet se Real Madridi po monitoron sulmuesin italian, pasi Lopetegui është një admirues i tij që kur drejtonte Porton, madje dëshironte ta afronte në Portugali. 20-vjeçari ka rinovuar së fundmi kontratën deri në vitin 2023 me Milanin dhe do të jetë shumë e vështirë që kuqezinjtë të pranojnë një ofertë për një talent si Cutrone.



**Autor: GAZMEND MORINA**

KËNGËTARI NË FOTO (Mbiemri)
TËRËSIA E RREZEVE DHE E ENERGJISË QË LËSHON DIELLI
KLUB FUTBOLLI HOLANDEZ
INTERNATIONAL POLITICAL ECONOMY
DËMI, PRISHJA; HUMBJA
NDERIMI QË I BËHET DIKUJT KUR VJEN NË KONAK (arab.)
KARATEISTI ENVER (shq.)
VRIMË E MADHE DHE E THELLË NË TOKË (sh.shq.)
UDHËHEQËSI I NJË ORGANIZATE
SHKRONJË GREKE
SHKRONJAT E PARA / I SHQUAR, I DALLUAR
NË ÇFARË MASE
EPOKË (shq.) / AJRI I PASTËR MBI RETË
ZANORE
PRINC ARAB / "... DE ZHANIERO"
TË BUKURIT
LUTJA QË I BËHET ZOTIT (mysl.) / BASHKIM I HARMONISHËM I DISA TINGUJVE
KËNGËTARI NË FOTO (Emri)
KLUB FUTBOLLI NË ITALI (shqip.)
OBJEKTI I BISEDËS
KUNDREJT I VJETËR
E CAKUT MË TË POSHTËM
AKTORJA E FAMSHME MILLER / I BUKURI
TOKA E BËRË GATI PËR TË MBJELLË / PIKËNISJE
QETËSI, PREHJE SHPIRTËRORE
APETIT / IPSVICH
BASKETBOLLISTI TURK OMER .... / AKTORI EGJIPTIAN .... SHARIF (shq.)
NDJENJA E RESPEKTIT DHE E VLERËSIMIT TË LARTË QË SHFAQIM PËR DIKË
I VLERËSON NXËNËSIT ME NOTË / NJERIU QË E ADHUROJNË E SHUMË
RADIUM / AI QË BANON VAZHDIMISHT A GJATË NË NJË VEND
PROVINCË NË ITALI
ZANORE / MENDIM
NDËRRIM I MALLIT / AKTORJA SHQIPTARO-KROATE BERISHA
NJË (turq.) / LLOJ INSEKTI I MËRZITSHËM
RAFINERIA E ZAGREBIT
PJESË E SYRIT / SHTËPIA E PLEQVE
GJINI E LETËRSISË ARTISTIKE / VENDLINDJA E ODISEUT
ISTRES / GRIMCA MOLEKULARE
"KENIA"
NISESHTJA / MODELJA SHQIPTARO-AMERIKAN ÇUNMULAJ
DERA E THURUR ME THUPRA / PARAGRAF
I FILLOVA
KUNDREJT E BARDHA
PARIA E SHOQËRISË / I TRASH A I PRISH TEHUN
AI QË ZOTËRON NJË PASURI A DIÇKA TJETËR / DËSHMORI KODRA (shq.)
SHKRIMTARI .... ZOLA (shq.) / BANORI I NJË QYTETI TË SHQIPËRISË
SHTET NË EVROPË (pashq.) / MIRËQENIE (sh.shq.)
FUTBOLLISTI ANGLEZ LENON / CILI MË RADHË
BASHKËT.
SËMUNDJA E TOKËS / STUHI E FORTË ME SHI
AI QË E KISHTE DOBËSI THEMBRËN / PEZMATIM I VESHIT (sh.shq.)
PËREMËR PRONOR / MUZIKANTI PRESHEVA (shq.)
FUTBOLLISTI ANGLEZ UEJN .... (MAN. UTD.)
FUTBOLLISTI ITALIAN MASIMO / ISH MAFIOZI .. KAPONE
VENDËSE / I ZURA ME DORË
IDRIZ SEFERI / INDIANA
"... ME TRI HARQE"
GJENDJE PLOGËSHTIE SHPIRTËRORE / KRYEHOXHË
THIRRJA E MYEZINIT / KITARISTI ANGLEZ KLEPTON
ZANORE
TEDI ARBELOA
QË KA TË BËJË ME PARAARDHËSET TONA / LEJE PËR TË SHKUAR NGA KONAKU
INTENSITET, TITAN / I PËRTYP
KOHË KUR NIS TË ZBARDHË DITA
GRADË USHTARAKE (shq.) / "TUNIZIA"
ISMET SULEJMAN / URUGUAI, TAJLANDA
QILIMI / BASHKËT.
ZANORE / ISLANDA
RETH QË VIHET NË GISHT (sh.shq.) / I MALLKUAR
FUQIA, FORCA
BOR, URAN
NIS TË ZBARDHË DITA
RAMADAN (perkdh.)
ARKA SHTETËRORE (Lat.)
TIRA

# SUDOKU

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2 | 6 | | 3 | 1 | | 9 | 8 | |
| | | 4 | 2 | | 5 | | 3 | |
| 7 | | | | | | | 5 | 2 |
| 5 | | 1 | 8 | | 4 | | 2 | 6 |
| | 4 | 2 | | | | 8 | 9 | |
| 8 | 9 | | 6 | | 3 | 4 | | 5 |
| 1 | 7 | | | | | | | 8 |
| | 5 | | 7 | | 9 | 2 | | |
| | 2 | 6 | | 3 | 8 | | 7 | 9 |

**ZGJIDHJA E SUDOKUT TË KALUAR**

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 3 | 7 | 4 | 5 | 1 | 6 | 2 | 9 | 8 |
| 5 | 9 | 2 | 8 | 3 | 4 | 6 | 7 | 1 |
| 6 | 8 | 1 | 9 | 7 | 2 | 5 | 4 | 3 |
| 2 | 6 | 5 | 3 | 8 | 7 | 4 | 1 | 9 |
| 9 | 3 | 8 | 2 | 4 | 1 | 7 | 5 | 6 |
| 4 | 1 | 7 | 6 | 9 | 5 | 8 | 3 | 2 |
| 1 | 4 | 6 | 7 | 2 | 9 | 3 | 8 | 5 |
| 7 | 2 | 3 | 1 | 5 | 8 | 9 | 6 | 4 |
| 8 | 5 | 9 | 4 | 6 | 3 | 1 | 2 | 7 |

ZGJIDHJA E FJALËKRYQIT: IDRIZI, GROPAT, LIDERI, ETA, AB, SA, ERA, I, EMIR, ARTI, IBADET, SIENA, UGARI, EUTIMI, OREKS, ONAN, NDERIMI, I NOTON, RA, RIMINI, I, TRAM, BIR, KE, AMIDONI, TRINA, E ZEZA, ELITA, I ZOTI, EMILI, ITALI, ARON, K, ILETI, AKILI, IMI, RUNI, ODO, ANASE, IS, URA, APATI, EZANI, A, TA, ILIRIKE, ITI, AGIM, TETARI, I, UNAZAT, TEPIHU, I NËMUR, TAKATI.

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
**Qeveria - Vlada - Government**

*Ministria e Arsimit,e Shkencës dhe e Teknologjisë*
*Ministarstvo Obrazovanja, Nauke i Tehnologije*
*Ministri of Education, Science end Technology*

Në pajtim me dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligji nr.03/ L -149, neni 12, paragrafi 4, *Ministria e Arsimit,e Shkencës dhe e Teknologjisë shpall*:

**Konkurs për "*Marrëveshje për shërbime të veçanta*"**

**Institucioni:** *Ministria e Arsimit,e Shkencës dhe e Teknologjisë*

**Divizioni:** **Prokurimit**
**Paga bruto:** **423.47 €**

**Titulli i vendit të punës: Zyrtar për mallra dhe shërbime (1 vend pune)**

**Kohëzgjatja e kontratës: 6 muaj**

**Vendi i punës: Prishtinë Datë: 04.09.2018**

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

1. Udhëheqja e lëndëve ( me të cilat ngarkohet nga ana e kryesit të divizionit të prokurimit) dhe përcjellja prej fillimit gjer në finalizim në përputhje me ligjin e ri të prokurimit publik;
2. Përpilimi i të gjitha kontratave;
3. Përcaktimi i kushteve përmbajtsore të kontratave publike;
4. Inicimi i aktiviteteve të prokurimit (shpalljet, mbledhja, hapja dhe vlerësimi i ofertave;
5. Përcaktimi i afateve kohore të tenderve publik;
6. Ushtrimi i aktivitetit të prokurimit në mënyrë transparente, pa diskriminim dhe duke ruajtu sekrete afariste;
7. Kryen punë tjera të caktuara nga udhëheqësi konform detyrave të punës.

*Kualifikimet*

1. Diploma universitare, 3 muaj përvojë pune në prokurim.
2. Aftësin e organizimit të punës individuale dhe ekipore
3. Aftësia e pranimit dhe komunikimit me palë
4. Aftësia e të shprehurit në gjuhën e komuniteteve dhe Angleze
5. Dituri në zbatimin e ligjit të prokurimit dhe ligjeve tjera që reflekton në prokurim.
6. Dituri nga përpunimi i të dhënave kompjuterike.
7. Zotësia në komunikim, shprehje, sqarim në dhënjën e informatave të ndryshme.

**Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:**
Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, të kenë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe aftësitë fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

**Data e mbylljes së konkursit:** Konkursi mbetet i hapur 7 ditë kalendarike nga dita e publikimit në uebfaqen e MASHT-it dhe shtypin ditor. Data e mbylljes së konkursit 10.09.2018.

Kandidatët aplikacionin (formularin për konkurrim) mund ta tërheqin në web faqen e MASHT-it **http://masht.rks-gov.net/**, ose ta marrin në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Rr. "Agim Ramadani" nr. 1 në zyrën e arkivit ku edhe i dorëzojnë aplikacionet e plotësuara.

**Aplikacionit duhet t'i bashkangjiten:** Kopja e letërnjoftimit, kopjet e dokumentacionit të kualifikimit, si dhe dokumentacione tjera të nevojshme sipas konkursit.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuara, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
**Qeveria - Vlada - Government**

*Ministria e Arsimit,e Shkencës dhe e Teknologjisë*
*Ministarstvo Obrazovanja, Nauke i Tehnologije*
*Ministri of Education, Science end Technology*

U skladu sa odredbama Zakona o civilnoj službi Republike Kosova Zakona br. 03/ L -149, član 12, stav 4, *Ministarstvo obrazovanja, nauke i tehnologije* **objavljuje:**

**Konkursa za "*Sporazum o posebnim uslugama* "**

**Institucija** *Ministarstvo obrazovanja, nauke i tehnologije*

**Divizija:** **Nabavke**
**Plata bruto:** **423.74€**

**Naziv radnog mesta: Službenik za robe i usluge (1 radno mesto)**

**Vreme trajanja ugovora: 6 meseci**

**Radno mesto: Priština Datum: 04.09.2018**

**Radni zadaci i odgovornost**

1. Upravljanjem predmetima (kojima će biti obavezan od strane predsedavajućeg Divizije nabavke) i praćenje od početka do kraja u skladu sa novim Zakonom o javnim nabavkama;
2. Sastavljanje svih ugovora;
3. Utvrđivanje sadržajnih uslova javnih ugovora;
4. Iniciranje aktivnosti nabavke (objavljivanje, prikupljanje, otvaranje i vrednovanje ponuda;
5. Utvrđivanje vremenskih rokova za javne tendere;
6. Primena aktivnosti nabavke na transparentan način, bez diskriminacije i održavanjem poslovnih tajni;
7. Izvršava druge zadatke koje dodeljuje lider u skladu sa zadacima..

*Kvalifikacije*

1. Univerzitetska diploma., 3 meseca radnog iskustva u nabavci
2. Sposobnost organizovanje individualnog i ekipnog;
3. Sposobnost prijema i komunikacije sa strankama;
4. Sposbnos govora na jezicima zajednica i engleski;
5. Poznavanje primena zakona o javnim nabavkama i druge zakone koje se odražavaju u nabavci;
6. Poznavanje obrade podataka kompjuterom;
7. Sposobnost komuniciranja, izražavanja, pojašnjenja u pružanju različitih informacija.

**Uslovi učešće na konkurs:**
Pravo na aplikaciju imaju svi punletni građani Republike Kosova koji imaju punu sposobnost delovanja, da imaju potrebnu školsku spremu i profesionalnu sposobnost za izvršavanje obaveze i ona lica koja imaju fizičku sposobnost koja se zahteva za relevantan položaj.

**Datum završetka konkursa:** Konkurs je otvoren 7 kalendarska dana od dana objavljivanje na web stranici MONT-a i dnevnoj štampi. Dan završetka konkursa je **10.09.2018.**

Kandidati aplikacija ( obrazac za konkurisanje ) mogu preuzeti na web stranici MONT-a **http://masht.rks-gov.net/**, ili u Ministarstvo obrazovanja, nauke i tehnologije, Adresa: Ul. "Agim Ramadani" br. 1, kancelariji arhive u kojoj će kasnije takođe popunjene aplikacije predati.

**Uz aplikaciju mora biti priložena:** Kopija lične karte, kopija dokumentacije o kvalifikovanju, kao i ostala dokumentacije potrebna koja se zahtevaju konkursom.

Zahtevi dostavljeni nakon isteka konkursa neće biti primljeni. Zbog velikog broja primljenih zahteva, kontaktiraćemo samo kandidati koji budu izabrani na užoj listi.

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

MINISTARSTVO KULTURE, OMLADINE I SPORTA/ MINISTRY OF CULTURE YOUTH AND SPORTS

DEPARTAMENTI I FINANCAVE DHE SHËRBIMEVE TË PËRGJITHSHME / DEPARTMENT OF FINANCES AND GENERAL SERVICES / DEPARTMAN I FINANSIJA I GENERALNIH USLUGA

*DIVIZIONI I BURIMEVE NJERËZORE / DIVISION OF HUMAN RESOURCES / DIVIZIJA LJUDSKIH IZVORA*

Bazuar në Ligjin e Punes Nr.03/L-212,Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, L. nr. 03/L-149, Rregulloren nr. 02/2010, për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit shpall:

## KONKURS

**I.**
**Titutulli i punës:**Zyrtar për Sport
**Kategoria funksionale:**Koeficienti 7
**Numri i Referencës:**44/2018
**I përgjigjet:** Udhëheqësit të Divizionit për Koordinim me Federata
**Vendi:**Prishtinë
**Detyrat dhe përgjegjësitë:**Nën mbikëqyrjen e Udhëheqësit të Divizionit për Koordinim me Federata i kryen detyrat dhe përgjegjësitë e mëposhtme:
**Lloji i kontratës:**"Marrëveshje për Shërbime të Veqanta"(kohëzgjatja 6 Muaj)

Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. Zhvillon dhe arrin pëlqimin për planet e punës dhe afatet,në koordinim me mbikëqyrësin,për zbatimin e projekteve,shërbimeve dhe produkteve përkatëse në fushën profesionale specifike;
2. Kryen detyra e parapara në planet e punës të miratuara në përputhje me ligjet,rregulloret,politikat dhe procedurat përkatëse,brenda afateve kohore të caktuara;
3. Bën hulumtime,analiza,vlerësim të opsioneve dhe rekomandime për shqyrtim nga nivelet e larta rreth detyrave ose projekteve të specializuara të miratuara;
4. Udhëheq grupet punuese në fushën profesionale specifike kur kërkohet një gjë e tillë;
5. Ofron këshilla për stafin e nivelit më të ulët brenda njësisë organizative për ekzekutimin e detyrave dhe përgjegjsive të tyre;
6. Ofron këshilla në fushën e ekspertizës të kërkuar brenda institucionit;
7. Koordinon punën me pjesët tjera të institucionit dhe komunikon,sipas nevojës,me autoritet e jashtme;
8. Kryen çdo detyrë tjetër në fushën profesionale specifike në përputhje me ligjet dhe rregulloret aktuale të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyshme kohë pas kohe;

